
BULETIN INFORMATIV

MARS 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Mars, 2026

Përmbajtje

Aktivite	6
Delegacioni i ASHAK-ut, vizitë zyrtare në Tiranë, takim me përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	7
Delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës pritet nga Presidenti i Republikës	10
Zëvendëspresidenti i Akademisë së Shkencave të Lituanisë, takim me Kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushin	12
U zhvillua takimi i anëtarëve të redaksisë vendore dhe redaktorëve përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia Shqiptare”	14
U promovua "Fjalori i madh i gjuhës shqipe" në Universitetin e Elbasanit	16
Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Universiteti i Elbasanit forcojnë bashkëpunimin në kërkimin shkencor dhe arsimin universitar	18
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës vlerëson akademikët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe”	20
“Fjalori i madh i gjuhës shqipe” prezantohet në Universitetin e Oksfordit nga prof. Manjola Zaçellari	23
U mbajt konferenca dyditore “Viti arkeologjik 2025”	25
Në nderim të jetës dhe veprës së akademikut Bahri Beci, u zhvillua veprimtaria shkencore me rastin e 90-vjetorit të lindjes	28
U mbajt workshop-i me temën “Ngritja e Grave në STEM – lidërsip, inovacion dhe besim”	31
Dita Ndërkombëtare e Ujit!	33
Dita Ndërkombëtare e Matematikës	34
Dita e Verës, historia dhe traditat e një feste të lashtë	35
Komisionet dhe Institutet	36
Akademiku Anastas Angjeli takon Presidentin e Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit.....	37

Komisioni i përhershëm i ekonomisë zhvilloi forumin me temë: Turizmi në epokën digjitale: Shqipëria drejt një të ardhmeje të qëndrueshme dhe teknologjike!.....	38
Komisioni i përhershëm i mjekësisë zhvillua tryeza shkencore për prezantimin e librit “Shëndeti dhe sëmundja” të prof. dr. Eduard Kakarriqit	40
U mbajt mbledhja e Komisionit të Fizikë-Kimisë	42
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë zhvilloi tryezën shkencore “Frederik Rreshpja në poezi e përjetësi”	44
U zhvillua tryeza shkencore me temën “Gjeografia përtej stigmës si shkencë/ disiplinë e fakteve dhe informacionit”	45
U zhvillua webinar-i me temën: “Menaxhimi i ujit të stuhive në epokën e urbanizimit: Sfida për Shqipërinë”	47
“Etnotoponomastikë: shtigje kërkimi”, ditë studimore në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë.....	48
Promovime dhe botime.....	50
U promovua libri “Sali Vranishti kapedani që nuk i mbylli sytë as në bronz”	51
U promovua në Tiranë libri “Kur heshtja flet” i autorit Ahmet Shala	53
Promovohet libri më i ri i shkrimtarit Namik Dokle “Atje ku dielli lind dy herë – Saga e Gorës” 56	
U promovua botimi “Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti” në nderim të prof. Bardhyl Demiraj.....	59
Fjalë përshëndetëse nga Kryesia e Akademisë së Shkencave në promovimin e librit "Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti" në nderim të prof. dr. Bardhyl Demirajt.....	62
“Ditari i tranzicionit ekonomik: Shqipëria më afër Bashkimit European”, libri XII, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	65
Të tjera.....	67
Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë akademik Besim Elezit: Gëzuar ditën e lindjes!.....	68
Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes akademikun Nazim Gruda	70
Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes akademikun Adem Bunguri.....	73
Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron akademikun Stefan Çapaliku në ditën e lindjes.....	75
Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron sot në ditën e lindjes akademikun Floresha Dado.....	77

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron antropologun akademik Albert Doja në ditën e lindjes	79
Kryesia e Akademisë së Shkencave i uron poetit akademik Xhevahir Spahiut: Gëzuar ditëlindjen!	81
Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron për festën e 7 Marsit- Ditën e Mësuesit	83
In memoriam	84
Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta fizikanin e talentuar akademik Artan Boriçin	85
Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta Aleksandër Moisiun, aktorin shqiptar me famë botërore	87
Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton në ditën e tij të lindjes veprimtarin e Rilindjes Kombëtare, poetin dhe dramaturgun Andon Zako Çajupi	89
Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta filozofin dhe akademikun Zija Xholi	91
Kujtojmë në ditën e lindjes Selim Islamin figurë e rëndësishme e arkeologjisë shqiptare, themelues i saj	93
Kujtojmë në ditën e lindjes Faik Konicën, një nga personalitetet më në zë të kulturës dhe letërsisë shqiptare	95
Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton në ditën e tij të lindjes gjuhëtarin dhe shkrimtarin Aleksandër Xhuvani	97
Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta Dhimitër Kamardën, gjuhëtarin dhe atdhetarin e madh arbëresh	98
Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta Fan Stilian Nolin, një figurë themelore të historisë dhe kulturës shqiptare	100
Kujtojmë humanistin, studiuesin dhe përkthyesin Henrik Lacaj	102
Akademia e Shkencave kujton me nderim në ditën e tij të lindjes gjuhëtarin e shquar akademik Mahir Domin	104
Akademia e Shkencave përkujton në ditën e tij të lindjes poetin arbëresh Zef Serembe	106
Kujtojmë në ditën e lindjes patriotin e shquar Kostandin Çekrezi, figurë e rëndësishme e historisë dhe publicistikës shqiptare	108

Aktivitete

Delegacioni i ASHAK-ut, vizitë zyrtare në Tiranë, takim me përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Në datën 2 mars 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u prit për një vizitë zyrtare delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK), i përbërë nga kryesia e re. Takimi u mbajt me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërakademik dhe institucional ndërmjet dy institucioneve më të larta shkencore në hapësirën shqiptare.

Delegacioni i ASHAK-ut përbëhej nga kryetarja akad. Justina Shiroka Pula, sekretari shkencor akad. Bardh Rugova, si dhe sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akad. Frashër Demaj.

Në ditën e parë të vizitës zyrtare delegacioni u prit nga kryetari i ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi dhe anëtarët e kryesisë së Akademisë. Pjesë e takimit ishte edhe zëvendëskryetarja e Komisionit për Edukimin, Shkencën dhe Sportet pranë Kuvendit të Shqipërisë znj. Evis Kushi.

Gjatë takimit me kryesinë e ASHAK-ut, kryetari i ASHSH-së akad. Gjinushi theksoi se

aktivitetet kryesore i zhvillojmë së bashku në bazë të protokollit dhe se fokusi kryesor janë projekti i enciklopedisë shqiptare dhe ngritja e dy qendrave elitare në nano e bioteknologji. Në takim u diskutua për konkretizimin e bashkëpunimit shkencor ndërmjet dy akademive, nëpërmjet projekteve të përbashkëta kërkimore. Të dyja palët vlerësuan rëndësinë e intensifikimit të komunikimit dhe bashkërendimit në fusha me interes të përbashkët, duke theksuar rolin e institucioneve akademike në mbështetje të proceseve zhvillimore dhe politikave publike në ekonomi dhe arsim.



Znj. Evis Kushi shprehu kënaqësinë dhe vlerësimin për zgjedhjen e akad. Justina Shiroka Pula si kryetare e ASHAK-ut me bindjen se ajo do t'i japë një impuls të ri si rritjes së punës nga ASHAK-u, ashtu dhe bashkëpunimit me ASHSH-në. Ajo u shpreh gjithashtu se Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka pësuar një reformim të thellë gjatë këtyre viteve të fundit dhe nga një Akademi që para ca vitesh ishte pasive, sot është avangardë e shkencës dhe ka një mbështetje të jashtëzakonshme për të gjitha këto projekte të rëndësishme.

Kryesia e re e ASHAK-ut në shoqërimin e zv. kryetarit të ASHSH-së, akad. Vasil S. Tole, zhvilloi një takim me kryetarët e komisioneve dhe njësisve përkatëse të institucionit. Në fokus të takimit ishte konfirmimi i vullnetit të ndërsjellë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy akademive, forcimi i koordinimit institucional dhe rritja e kontributit të tyre në zhvillimin shkencor, arsimor dhe shoqëror në hapësirën shqiptare. Takimi shërbeu për një njohje më të mirë me strukturat që punojnë pranë ASHSH-së e me fushat e tyre të

interesit.

Vizita e delegacionit të ASHAK-ut vijoi me takimin me drejtorët e instituteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Pas takimit u bë një vizitë në Muzeun e Arkeologjisë në Tiranë.

Më vonë delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i përberë nga kryetarja e ASHAK-ut akad. Justina Shiroka Pula, sekretari shkencor akad. Bardh Rugova, si dhe sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut akad. Frashër Demaj, i shoqëruar nga zëvendëskryetari akad. Vasil Tole dhe kryetari i Komisionit të Shkencave të Ekonomisë dhe Juridike akad. Anastas Angjeli, bëri një takim me rektorin e Universitetit të Tiranës prof. dr. Artan Hoxha.

Kryetarja e ASHAK-ut paraqiti një analizë të shkurtër të gjendjes së arsimit të lartë në Kosovë dhe foli për nismat e marra për zhvillimin e Universitetit të Prishtinës.

Ajo bëri një pasqyrim të punësimit të të diplomuarve dhe theksoi se universiteti duhet të bëjë një punë më të mirë për profilizimin e kuadrit, ndërkohë që universitetet private janë më atraktive për tregun e punës, por jo gjithmonë më cilësoret. Nga ana tjetër rektori i UT-së, prof. dr. Hoxha, e falënderoi akad. Justina Pula Shirokën për përkujdesjen e treguar të Akademisë së Kosovës për arsimin dhe u shpreh se edhe kërkimi shkencor duhet të bashkohet me strategjinë e arsimit të lartë.

Në kuadër të vizitës dyditore në Republikën e Shqipërisë, delegacioni i ASHAK-ut do të zhvillojë disa takime me drejtues të institucioneve kryesore në vend.



Delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës pritet nga Presidenti i Republikës



Delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) përmbylli vizitën zyrtare dyditore në Tiranë, e cila u realizua në kuadër të thellimit të bashkëpunimit institucional dhe shkencor me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.


Gjatë qëndrimit, delegacioni i ASHAK-ut i përbërë nga kryetarja akad. Justina Shiroka Pula; sekretari shkencor akad. Bardh Rugova, si dhe sekretari i Seksionit të Shkencave Shoqërore akad. Frashër Demaj, të shoqëruar nga anëtarët e Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole dhe akad. Anastas Angjeli zhvilluan takime me përfaqësues të lartë institucionalë. Në këto takime u diskutua mbi avancimin e bashkëpunimit ndërakademik, koordinimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, si dhe fuqizimin e rolit të akademive në trajtimin e çështjeve me interes të përbashkët shkencor dhe kombëtar.

Në ditën e sotme delegacioni u prit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bajram Begaj. Ai i përgëzoi kryetarët e akademive për bashkëpunimin e deritanishëm në

projekte që nxisin promovimin e elementëve identitarë kombëtarë dhe çmoi gjithashtu tematikat e konferencave të përbashkëta të organizuara nga të dyja akademitë, veçanërisht ato të demografisë, si tema me rëndësi për sigurinë kombëtare.

Në mënyrë të veçantë, presidenti z. Begaj shprehu përgëzime për projektin më të madh të dy akademive “Enciklopedinë e shqiptarëve”. Presidenti garanto mbështetjen e tij si kryetar shteti dhe të institucioneve shqiptare për çdo projekt që synon promovimin e historisë sonë kombëtare përmes fakteve dhe të vërtetave shkencore.

Më pas delegacioni u prit në një takim miqësor zyrtar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko.



Zëvendës-presidenti i Akademisë së Shkencave të Lituanisë, takim me Kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushin



Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe shkëmbimit të përvojave akademike, më 25 mars, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua një takim me zëvendës-presidentin e Akademisë së Shkencave të Lituanisë, prof. dr. Aivaras Kareiva. Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe bashkëpunuese, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, si dhe anëtarëve të kryesisë.

Gjatë fjalës së tij, akad. Gjinushi vlerësoi marrëdhëniet me Akademinë e Shkencave në Lituani, ku theksoi procesin e reformimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ai u ndal në ndryshimet ligjore që kanë mundur riorganizimin e institucionit, përfshirë ngritjen e njësive të përkohshme dhe të përhershme, si dhe funksionimin e pesë instituteve kërkimore pranë saj.

Në vijim, ai theksoi rëndësinë e zhvillimit të fushave bashkëkohore si nanoteknologjia dhe inteligjenca artificiale, duke marrë si model përvojën e Lituanisë. Në këtë kuadër, u përmend edhe synimi për ngritjen e një qendre rajonale kërkimore dhe një qendre për shkencat e jetës pranë Universitetit Bujqësor.



Në fushën e projekteve kërkimore, ai theksoi se Akademia mbështet si projektet e financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), ashtu edhe iniciativat e veta, ndërsa për projektet madhore kërkohet mbështetje nga qeveria. Ndër arritjet kryesore përmendi përfundimin e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipes”, një projekt i realizuar në bashkëpunim me specialistë nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe punën në vijim për hartimin e “Enciklopedisë shqiptare” dhe projektit për “Historinë e shqiptarëve”.

Në takim u diskutua edhe për zhvillimin e projekteve të përbashkëta mes dy akademive. Akad. Gjinushi theksoi organizimin çdo vit në Shqipëri të një konference ndërkombëtare për nanoteknologjinë, me pjesëmarrjen e rreth 250 specialistëve nga 25 - 30 vende të botës, duke shprehur interes për bashkëpunim me studiuesit lituanëzë në këtë drejtim.

Nga ana e tij, zëvendëspresidenti i Akademisë së Shkencave të Lituanisë, prof. dr. Aivaras Kareiva, shprehu gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin, duke theksuar eksperiencën e institucionit që përfaqëson në organizimin e konferencave ndërkombëtare, përfshirë bashkëpunimin me Akademinë Polake të Shkencave, si dhe mundësinë e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta në vitin 2027.

Takimi u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit midis dy akademive dhe krijimit të urave të reja në fushën e kërkimit shkencor.

U zhvillua takimi i anëtarëve të redaksisë vendore dhe redaktorëve përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia Shqiptare”



Mbledhja u mbajt në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, më 10 mars 2026, me pjesëmarrjen e anëtarëve të redaksisë vendore dhe redaktorëve përgjegjës për projektin madhor “Enciklopedia Shqiptare”, me organizimin e Qendrës së Studimeve Enciklopedike dhe Albanologjike (QBEA), pjesë e ASHSH-së.

Takimi u drejtua nga akad. Skënder Gjinushi, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe kryeredaktor i “Enciklopedisë shqiptare”.

Në fjalën e hapjes, akad. Gjinushi vlerësoi punën e deritanishme të anëtarëve të redaksisë vendore dhe të redaktorëve përgjegjës në hartimin e fjalësit enciklopedik, si dhe në koordinimin e zërave me redaksitë përkatëse në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Ai theksoi se prej dy vitesh janë angazhuar 27 redaksi të fushave të ndryshme, të cilat kanë punuar për trajtimin e fjalësit përkatës. Qëllimi i këtij takimi ishte të merrej një informacion i drejtpërdrejtë mbi gjendjen e plotësimit të fjalësve me autorët e artikujve dhe kategorizimin e tyre brenda afatit të parashikuar, 31 mars.

Drejtori i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, z. Andreas Dushi paraqiti një pasqyrë të ecurisë së deritanishme të punës në redaksitë e fushave. Po ashtu, ai vuri në dukje se disa redaksi paraqesin specifika të veçanta. Sipas raportimit, vetëm 5 redaksi kishin ende disa mungesa të cilat do të plotësohen brenda kësaj periudhe. U ritheksua nevoja e komunikimit të ndërsjellët si kusht i domosdoshëm për avancimin e punës në të ardhmen.



Ndërkohë, Kryetari i Akademisë nënvizoi si një nga aspektet kryesore të diskutimit nevojën për një koordinim më të ngushtë ndërmjet redaksisë qendrore, redaksisë vendore të riorganizuar, Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike dhe redaksive të fushave.

Në këtë kuadër, u theksua rëndësia e përcaktimit të një personi përgjegjës brenda çdo redaksie vendore që të marrë rolin e koordinatorit për ndjekjen dhe harmonizimin e punës. Sipas akad. Gjinushit, për ecurinë sa më të mirë të projektit është e dëshirueshme që këtë rol ta mbajë vetë përgjegjësi i redaksisë; megjithatë, në varësi të angazhimeve dhe ngarkesës së punës, redaksitë mund të vendosin vetë për personin që do të kryejë këtë funksion koordinues.

Akad. Shabani Sinani, anëtar i redaksisë qendrore e përgjegjës i seksionit për “Enciklopedinë Shqiptare” i njohu të pranishmit me kriteret e procedurat e përgjithshme që do të ndiqen gjatë hartimit të fjalësit, të cilat do të përfshihen në udhëzuesit në procesin e përgatitjes.

Takimi u zhvillua në frymën e bashkëpunimit dhe të angazhimit të përbashkët për avancimin e mëtejshëm të punës në një nga projektet më të rëndësishme shkencore dhe botuese të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, “Enciklopedia Shqiptare”, me synim të qartë fillimin e shkrimit të artikujve.

U promovua "Fjalori i madh i gjuhës shqipe" në Universitetin e Elbasanit



Projekti madhor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” është promovuar sot, në datën 19 mars 2026, nga departamenti i gjuhësisë, Fakulteti i Shkencave Humane, në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin: kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetari i ASHSH-së akad. Vasil Tole dhe akad. Valter Memisha.

Akad. Skënder Gjinushi shprehu kënaqësinë për pjesëmarrjen në këtë aktivitet, duke e cilësuar fjalorin si një nga botimet madhore të Akademisë së Shkencave, të hartuar në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë në vend. Ai falënderoi në mënyrë të veçantë Universitetin e Elbasanit dhe Departamentin e Gjuhësisë për bashkëpunimin e ngushtë në realizimin e kësaj vepre.

Kryetari i ASHSH-së theksoi se zhvillimi i shkencave albanologjike është një nga misionet kryesore të Akademisë së Shkencave, e cila gjatë pesë viteve të fundit ka ndërmarrë tri projekte madhore: “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe”, “Enciklopedinë shqiptare” dhe “Historinë e shqiptarëve”. Ai vuri në dukje se hartimi i fjalorit ishte një domosdoshmëri e kahershme, me mbi 20 vite pritjeje, dhe një hap i rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës standarde shqipe, si dhe për krijimin e vijimësisë mes brezash.



Gjithashtu, pranë Akademisë së Shkencave është krijuar një qendër e posaçme për botimet enciklopedike dhe albanologjike, e cila ka pasur si detyrë organizimin e këtyre projekteve madhore. Akad. Gjiniushi theksoi se, ndonëse Akademia ka një rol koordinues, realizimi i veprave të tilla nuk mund të bëhet pa bashkëpunimin e ngushtë me institucionet e arsimit të lartë.

“Fjalori i madh i gjuhës shqipe” përfaqëson një arritje të rëndësishme në fushën e leksikografisë shqiptare, me vlera të veçanta për studiuesit, pedagogët, mësuesit dhe studentët, si dhe për të gjithë ata që kontribuojnë në zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Universiteti i Elbasanit forcojnë bashkëpunimin në kërkimin shkencor dhe arsimin universitar



Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, më 19 mars 2026, kanë firmosur një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synon të thellojë lidhjet ndërinstitucionale dhe të nxisë zhvillimin e përbashkët në fushën e kërkimit shkencor dhe formimit akademik të brezave të rinj.

Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe rektorja e Universitetit të Elbasanit prof. dr. Elvira Fetahu.

Kjo marrëveshje shënon një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një platforme të qëndrueshme bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, me synim avancimin e dijes dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Në fokus të saj është zhvillimi i studimeve dhe hulumtimeve shkencore në të gjitha fushat e dijes, si dhe përfshirja aktive e studentëve dhe studiuesve të rinj në projekte kërkimore. Nisma është në përputhje me strategjinë e Akademisë së Shkencave për hapje dhe bashkëpunim me komunitetin akademik, si dhe me politikat e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për zgjerimin e partneriteteve dhe rritjen e ndërveprimit institucional.

Përmes kësaj marrëveshjeje synohet krijimi i një kuadri të qartë bashkëpunimi, i

cili përcakton format dhe mekanizmat e ndërveprimit ndërmjet strukturave përkatëse të të dyja institucioneve.

Bashkëpunimi do të përfshijë organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, projekte kërkimore, konferenca shkencore dhe shkëmbime akademike.



Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës vlerëson akademikët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe”



Një ceremoni e veçantë për vlerësimin e akademikëve e të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u mbajt në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës për kontributin në hartimin dhe hedhjen në sistemin online të veprës madhore leksikografike “Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe”.

Zëvendësministrja e Arsimit znj. Orjana Osmani dhe Rektori i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës prof. dr. Shkëlqim Fortuzi përgëzuan për punën e bërë Kryetarin e ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, si edhe akademikët Jani Thomai dhe Valter Memisha, së bashku me bashkëpunëtorët e tjerë të fjalorit, për angazhimin e palodhur dhe kontributin e çmuar në pasurimin e gjuhës shqipe, të shprehur me hartimin e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe” me rreth 125 000 fjalë e frazeologji.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Gjinushi në fjalën e tij theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë (IAL) e posaçërisht me Universitetin e Durrësit në realizimin e projekteve madhore kombëtare, përfshirë fjalorin, duke nënvizuar se ky punim duhet shtrirë në të gjithë fushat me qëllim rritjen e nivelit të kërkimit shkencor.



Akad. Valter Memisha, përcolli mesazhin e mirënjohjes së akad. Jani Thomait dhe më tej theksoi vlerën historike dhe shkencore të kësaj vepre, duke e cilësuar atë si një dëshmi të nivelit të lartë të studimeve albanologjike dhe të angazhimit serioz institucional në shërbim të gjuhës shqipe. Ai u shpreh se Akademia synon të forcojë rolin e saj si institucion aktiv në studimet shkencore dhe në përmbushjen e misionit kryesor në fushën e albanologjisë, duke ideuar tri projekte madhore, ndër të cilat edhe “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”.

“Fjalori është vepër e një pune katërvjeçare të ndërmarrë nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me institucionet përkatëse të fushës. Nevoja për një fjalor të tillë ka ekzistuar prej kohësh. Përpyqjet për hartimin e tij kanë nisur që në vitin 2006, e kjo u bë e mundur me mbështetjen e drejtpërdrejtë prej kryetarit të ASHSH-së e më tej prej Akademisë si institucion. Për realizimin e kësaj vepre u ftuan specialistë të fushës nga të gjitha trevat shqiptare dhe Arbëria, e sot kemi një vepër të mirëpritur prej specialistëve e opinionit në përgjithësi, e shprehur kjo nga interesimi i lartë, ku ka patur mbi 5 milionë klikime në 50 ditë.

Në vijim, Rektori, prof.dr. Shkëlqim Fortuzi, shpërndau certifikata vlerësimi për kontributin e jashtëzakonshëm në realizimin e kësaj vepre për Kryetarin e ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushin, si dhe për akademikët Jani Thomai e Valter Memisha.

Gjatë aktivitetit u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërinstitucional mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Marrëveshja u firmos nga Kryetari i Akademisë, akad. Skënder Gjinushi, dhe Rektori i Universitetit prof. dr. Shkëlqim Fortuzi. Kjo marrëveshje shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve të përbashkëta akademike.

Aktiviteti u mbyll me diskutime akademike mbi vlerën leksikografike të veprës dhe sfidat e gjuhës shqipe në kohën e digitalizimit.



“Fjalori i madh i gjuhës shqipe” prezantohet në Universitetin e Oksfordit nga prof. Manjola Zaçellari



Bashkëhartuesja e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”, njëherazi anëtare e Komisionit të përhershëm të gjuhës dhe letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe pedagoge në Universitetin e Durrësit, prof. asoc. dr. Manjola Zaçellari, referon në Universitetin e Oksfordit.

Prof. Zaçellari mori pjesë si referuese në konferencën ndërkombëtare Oxford Forum of Open Scholarship 2026, një aktivitet akademik i zhvilluar në datat 2 - 6 mars nga Bodleian Libraries, University of Oxford, në Mbretërinë e Bashkuar, i cili mbledh studiues, kërkues dhe ekspertë nga institucione të ndryshme ndërkombëtare për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në “open research”, “open data” dhe “open scholarship”.

Në kuadër të kësaj konference, më 4 mars, prof. Zaçellari prezantoi studimin “Open Structured Dictionary Data for Low-Resource Languages”, (Transforming The Great Dictionary of the Albanian Language into an Open Resource) ku trajtoi çështje që lidhen

me strukturimin dhe hapjen e të dhënave leksikografike për gjuhët me burime të kufizuara digjitale.

Gjatë prezantimit, ajo u ndal te një pyetje thelbësore që udhëhoqi më tej diskutimin me studiuesit e tjerë: “Kush e zotëron dijen gjuhësore?”, duke reflektuar mbi rolin e qasjes së hapur në burimet gjuhësore dhe mbi rëndësinë e ndarjes së dijes në komunitetin shkencor global.

Me këtë rast, prof. Zaçellari prezantoi “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe”, një nga veprat më të rëndësishme të leksikografisë shqiptare, duke theksuar vlerën shkencore të kësaj pune dhe rëndësinë e hedhjes së saj në platforma online si burim për “open data”.

Ky proces synon ta bëjë këtë pasuri të rëndësishme gjuhësore më të qasshme për kërkimin shkencor ndërkombëtar dhe për studiuesit e gjuhësisë e gjuhës shqipe në mbarë botën.

U mbajt konferenca dyditore “Viti arkeologjik 2025”



Punimet e konferencës shkencore dyditore u zhvilluan në datat 25 dhe 30 mars 2026, nga Instituti i Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Konferenca u hap nga kryetari i Institutit të Arkeologjisë, akad. Adem Bunguri, i cili e vlerësoi organizimin e saj si një moment për të prezantuar dhe vlerësuar punën dhe gjetjet arkeologjike të kryera gjatë vitit pararendës, si dhe për të evidentuar sfidat e kërkimit arkeologjik në terren dhe rezultatet e arritura nga projektet kërkimore. Ai falënderoi të gjithë autorët e gërmimeve dhe arkeologët për impenjimin, seriozitetin dhe rezultatet e kënaqshme, pavarësisht sfidave të shumta në terren.

Në fjalën përshëndetëse, përfaqësuesi i Kryesisë së Akademisë së Shkencave, njëkohësisht kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha, e vlerësoi këtë aktivitet si një moment të rëndësishëm reflektimi mbi punën kërkimore vjetore. Ai theksoi se konferenca përbën një hapësirë të privilegjuar për ndarjen e rezultateve më të fundit shkencore, për dialogun ndërmjet metodologjive bashkëkohore kërkimore dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjithashtu, ai vuri në dukje ndërthurjen e përvojës së gjatë të studiuesve me energjinë dhe qasjet e reja të kërkuesve të rinj, si dhe rolin e arkeologjisë shqiptare në kontekstin europian të kërkimit shkencor. Më tej, akad. Hoxha vlerësoi programin e pasur të konferencës, që dëshmon jo vetëm intensitetin e punës në terren, por edhe cilësinë dhe larminë e qasjeve metodologjike që karakterizojnë sot arkeologjinë shqiptare. Ai theksoi rëndësinë e rritjes së standardeve kërkimore dhe të përforsimit të bashkëpunimeve institucionale, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të mëtejshëm të studimeve arkeologjike dhe promovimin e trashëgimisë kulturore si një pasuri me vlera të pazëvendësueshme shkencore dhe identitare.

Punimet e konferencës u zhvilluan në tre sesione tematike.



Seanca e parë, e organizuar nga Departamenti i Prehistorisë dhe e drejtuar nga dr. Rovena Kurti, sollti rezultate të rëndësishme nga kërkimet në kompleksin karstik të Gajtanit, në vendbanimin e Podgories në zonën e Korçës, si dhe në fortifikimin prehistorik të Orenjës (Librazhd). Këto studime dëshmuuan për rritjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe përdorimin e metodave bashkëkohore në studimin e periudhave të hershme.

Seanca e dytë, e fokusuar në antikitet dhe e drejtuar nga prof. asoc. Sabina Veseli, paraqiti rezultate të reja nga qendra të rëndësishme arkeologjike si Apolonia, Bylisi dhe Antigonea, si dhe studime të peizazhit arkeologjik në zonat Memaliaj-Tepelenë dhe në luginën e Drinosit. Kërkimet theksuan rëndësinë e një qasjeje të integruar, ku qytetet antike trajtohen në marrëdhënie dinamike me territorin përreth.

Dita e dytë e konferencës u hap me prezantimin e projektit të Bylisit nga prof. dr. Neritan Ceka, ku u paraqitën të dhëna mbi germimet dhe projektet e restaurimit. Projekti realizohet nga studiues të Institutit të Arkeologjisë, me pjesëmarrjen e dr. Olgita Cekës

dhe dr. Suela Xhyherit si përgjegjëse gjërmimi, si dhe me kontributin e ekspertëve për kërkimin dhe restaurimin, ku konsulentë janë prof. dr. Neritan Ceka, prof. dr. Skënder Muçaj dhe Edmond Haxhiraj (restaurator, përgjegjës restaurimi).

Seanca e fundit, e drejtuar nga prof. asoc. Brikena Shkodra dhe e përqendruar në Antikitetin e Vonë dhe Mesjetën, paraqiti një gamë të gjerë studimesh, përfshirë kërkimet në luginën e Bulqizës, në Drisht dhe Hajmel, si dhe në vendbanime mesjetare në zonën e Tiranës. Diskutimet evidentuan interesin në rritje për transformimet historike, urbane dhe kulturore të periudhës së kalimit nga antikiteti në mesjetë.

Dita e dytë e konferencës pati vëmendjen e Kryetarit të ASHSH-së dhe anëtarëve të tjerë të Kryesisë, të cilët vlerësuan rezultatet e punës shkencore-kërkimore. Akad. Skënder Gjinushi, në fjalën e tij, dha sugjerime për një organizim më të zgjeruar të aktiviteteve shkencore, duke i shtrirë në disa ditë për diskutime më efektive.

Ai theksoi nevojën për një pasqyrim më të qartë të arritjeve vjetore dhe për zhvillimin më të dendur të debateve shkencore, si dhe vuri në dukje pengesat administrative dhe nevojën për përmirësimin e mekanizmave të financimit. Gjithashtu, propozoi krijimin e një databaze kombëtare për kërkimet arkeologjike. Në përfundim, akad. Gjinushi vlerësoi rolin e arkeologjisë në ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë kulturore.

Gjatë dy ditëve të konferencës, studiues, profesorë dhe specialistë të fushës diskutuan rezultatet më të fundit të kërkimeve arkeologjike, duke trajtuar zbulime nga periudha të ndryshme historike, si dhe projektet e restaurimit dhe konservimit të trashëgimisë kulturore.

Në fjalën përmbyllëse të konferencës, akad. Adem Bunguri u shpreh se konferenca “Viti arkeologjik 2025” konfirmoi rolin e saj të rëndësishëm shkencor në prezantimin e arritjeve, shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit arkeologjik në Shqipëri.



Në nderim të jetës dhe veprës së akademikut Bahri Beci, u zhvillua veprimtaria shkencore me rastin e 90-vjetorit të lindjes



Me rastin e 90-vjetorit të lindjes së akademikut Bahri Beci (1936–2023), studiuës i shquar i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvilloi më 6 mars 2026 një veprimtari përkujtimore në nder të figurës dhe trashëgimisë së tij shkencore. Aktiviteti u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe Komisioni i përhershëm i gjuhësisë dhe letërsisë pranë ASHSH-së.

Veprimtarinë e hapi zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole, i cili përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi figurën dhe kontributin e akademikut Bahri Beci në studimet albanologjike dhe në zhvillimin e gjuhës shqipe.

Akad. Tole theksoi dimensionin e spikatur ndërkombëtar të veprimtarisë së tij shkencore, duke e cilësuar akad. Becin jo vetëm si një studiuës të shquar të gjuhës shqipe, por edhe si një ambasador të saj në hapësirën europiane. Ai nënvizoi se botimet e tij në gjuhë të huaja kanë pasuruar bibliografinë gjuhësore të shqipes dhe kanë zgjeruar praninë e saj në auditorin akademik ndërkombëtar.

Në vijim të fjalës së tij, akad. Tole u ndal edhe te kontributi i veçantë i akad. Becit në studimin dhe standardizimin e gjuhës letrare, duke përmendur veprat “Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri” dhe “Historia e standardizimit të shqipes: politika dhe planifikimi gjuhësor në Shqipëri”, të cilat përbëjnë referenca të rëndësishme në studimet mbi politikën gjuhësore.

Në këtë veprimtari përshëndeti edhe prof. Tomorr Plangarica, i cili vlerësoi kontributin e akad. Bahri Becit në institucionalizimin dhe zhvillimin e dijes gjuhësore. Ai theksoi se përmes studimeve të tij, akad. Beci ka sjellë prurje të rëndësishme në fusha të ndryshme

të gjuhësisë, si dialektologjia e shqipes dhe struktura dialektore e saj, politika dhe planifikimi gjuhësor, standardizimi i gjuhës, norma gjuhësore, sistemi gjuhësor dhe problemet e standardizimit, si edhe ndikimi i gjuhës letrare mbi dialektet. Po ashtu, ai përmendi kontributet e tij në studimin e variacionit sociolinguistik, në mësimdhënien e shqipes si gjuhë amtare dhe për të huajt, në përdorimin e metodave statistikore në studimet gjuhësore, si edhe në hartimin dhe përdorimin e teksteve shkollore.



Në nder të përkujtimit të tij, prof. dr. Anila Omari u ndal në veçanti te kontributi i akad. Bahri Becit në studimet e dialekteve, duke theksuar se ai është marrë herët me çështjet e historisë së formimit të dialekteve të shqipes dhe me problemet e lashtësisë së ndarjes dialektore të saj. Ajo theksoi se interesimi i tij për historinë e tipareve dialektore shfaqet që në studimet e para të rëndësishme të viteve '60-të, ndër të cilat spikasin punimet "Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të gegnisë së mesme" (Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, 1962; botuar 1965) dhe studimi "Rreth kronologjisë dhe shkaqeve historike që kanë përcaktuar kalimin e y-së në ë në gegëni të mesme" (botuar në Shkodër, 1969).


Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë vlerësimi dhe respekti për figurën e akademikut Bahri Beci, ku ligjëruesit prof. dr. Mimoza Kore, prof. asoc. Enkelejda Kapia, dr. Plator Gashi, prof. dr. Mimoza Priku, prof. dr. Merita Bruci dhe dr. Valbona Sinanaj, rikujtuan

kontributin e tij të çmuar në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare dhe në promovimin e gjuhës shqipe në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Veprimtaria u përmyll me përshëndetjen e vajzës së akademikut Bahri Beci, e cila, në emër të familjes, shprehu mirënjohjen për organizimin e kësaj veprimtarie përkujtimore në nder të jetës dhe veprës së tij.



U mbajt workshop-i me temën “Ngritja e Grave në STEM – lidërsnip,



inovacion dhe besim”

Veprimtaria shkencore u zhvillua më 6 mars 2026 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me përgjegjësinë e njësisë së kërkim-studimit në nanoteknologji - NanoAlb, në bashkëpunim me anëtarë të “Albanian Women in Nanotechnology (AWIN)” nga Shqipëria dhe diaspora dhe me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquara në kërkimin shkencor në fushën e nanoteknologjisë.

Koordinatorja, prof. dr. Majlinda Vasjari, falënderoi pjesëmarrësit për organizimin e këtij workshopi, i cili synon të evidentojë rolin e grave shkencëtare në zgjidhjen e sfidave që lidhen me nanoshkencën dhe nanoteknologjinë.

Të ftuar specialë të workshopit ishin akad. Arben Merkoçi, drejtor dhe koordinator i NanoAlb pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe drejtues i grupit të nanobioelektronikës dhe biosensorëve në Institutin e Nanoshkencës dhe Nantoenologjisë ICN2 të Katalanjas, Spanjë; dr. Ardian Jusufi, udhëheqës i grupit, Universiteti i Cyrihut, Zvicër dhe dr. Visar Vela, Zvicër.

Hapja e veprimtarisë u bë nga dr. Gjyljije Hoti, ndërsa pjesëmarrësit i përshëndeti akad. Arben Merkoçi.

Workshop-i u zhvillua në dy sesione; ku u trajtuan temat: “Gratë shqiptare frymëzuese në STEM, përsosmëri dhe lidërsnip rajonal” dhe “Gratë lidere ndërkombëtare në STEM”, që u përqendrua në perspektivën globale, inovacionin dhe kërkimin ndërdisiplinor.

Ky takim, i organizuar me një pjesëmarrje të gjerë të personaliteteve të shquara nga bota dhe anëtarëve të Nano Alb, konsiderohet si një mundësi për të treguar përvoja të suksesshme dhe për të ofruar këshilla për brezin e ri të grave dhe vajzave dhe gjithashtu për t'i inkurajuar ato të angazhohen në kërkimin shkencor në fushën e nanoshkencës dhe nanoteknologjisë.

Dita Ndërkombëtare e Ujit!




Çdo vit, më 22 mars, shënohet Dita Ndërkombëtare e Ujit, një ditë që ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ujit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tij. Kjo ditë u përcaktua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në dhjetor 1992, dhe nga viti 1993 është pjesë e kalendarit zyrtar të OKB-së.

Dita Ndërkombëtare e Ujit fokusohet në një temë të veçantë që lidhet me sfidat dhe mundësitë në fushën e ujit që nga mungesa e ujit të pijshëm, ndotja e burimeve ujore, deri te përdorimi i qëndrueshëm dhe shpëtimi i ekosistemeve ujore.

Qëllimi i këtij celebrimi është të rritet ndërgjegjësimi global për mbrojtjen e burimeve ujore dhe të nxiten veprime konkrete nga vendet anëtare. OKB-ja dhe qeveritë e saj organizojnë aktivitete dhe promovojnë zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare për menaxhimin e ujërave, duke siguruar që secili vend të kontribuojë në ruajtjen e këtij burimi jetik.

Dita Ndërkombëtare e Matematikës



Më 14 mars, në mbarë botën shënohet Dita Ndërkombëtare e Matematikës, e cila synon të promovojë rëndësinë e matematikës në arsim, në kërkimin shkencor dhe në jetën e përditshme.

Kjo datë është zgjedhur simbolikisht, pasi në formatin e shkrimit të datës 3/14 ajo përkon me vlerën e përafërt të konstantës matematikore π (Pi), numrit 3.14.

Konstantja π përfaqëson raportin ndërmjet perimetrit të një rrethi dhe diametrit të tij dhe është një nga konstantet më të rëndësishme në matematikë. Ajo shfaqet në një gamë të gjerë aplikimesh në matematikë, fizikë, inxhinieri dhe në shkencat natyrore, duke dëshmuar rolin e pazëvendësueshëm të matematikës në përshkrimin dhe kuptimin e ligjeve që rregullojnë botën natyrore.

Matematika është një nga disiplinat themelore të dijes njerëzore dhe përbën bazën e zhvillimit të shumë fushave të shkencës dhe teknologjisë. Si shkencë ekzakte dhe si gjuhë universale e kërkimit shkencor, ajo luan një rol thelbësor në analizimin dhe shpjegimin e dukurive natyrore, në përparimin e inovacionit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë bashkëkohore

Dita Ndërkombëtare e Matematikës përbën një mundësi për të theksuar rëndësinë e kësaj discipline në zhvillimin e mendimit shkencor, për të inkurajuar brezat e rinj drejt studimit të saj dhe për të vlerësuar kontributin e matematikës në përparimin e dijes dhe të qytetërimit njerëzor.

Dita e Verës, historia dhe traditat e një feste të lashtë



Dita e Verës është kremtuar në mbarë viset shqiptare. Megjithatë, kremtimet kanë pasur nuanca të ndryshme për krahina të ndryshme. Etnologu i mirënjohur Bernardin Palaj, njohës i thellë i trashëgimisë kulturore sidomos të malësisë së Veriut, ka shkruar që në fillim të viteve '20 të shekullit të kaluar, për mënyrën se si festohej kjo ditë. Dita e Verës është festuar shumë kohë para se institucionet klerikale e, më pas, ato shtetërore të fillonin të administrojnë festat popullore. Si festë pagane, ajo është kremtuar që në lashtësi.

Si dëshmi po sjellin këtu dy përshkrime të kuptimit dhe kremtimit të "Ditës së Verës".

Përshkrimin e parë e kemi nga Faik Konica:

Ç'është Dita e Verës?

Është dita në të cilën shtërgjyshërit t'anë, kur s'kish lindur edhe krishtërimi, kremtojnë bashkë me Romanët dhe me Grekët e Vjetër, perëndit' e luleve, të shelgjeve, të krojeve. Kur çkrin dimëri, kur qaset Vera buzëqeshur e hollë dhe e gjatë si në piktyrë të Botticelli, zemra e njeriut çgarkohet nga një barë, shijon një qetësi, një lumtësi t'ëmbëlë. Në këtë gëzim, stërgjyshërit t'anë ndiejn një detyrë t'u falen perëndive që sillnin këto mirësira, dhe ashtu leu festa hiroshë që quajmë Dit' e Verës.(Faik Bej Konica, Botuar më 1911), i cili gati 100 vjet më parë, në kohën e sundimit osman, shkruante me atë stilin e vet elegant.

Ndërsa sipas akademik Kristo Frashërit dita e verës ka qenë pjesë përbërëse e identitetit tonë etnik. Edhe nëse në disa vise ajo filloi të venitej, përsëri duhet të rigjallërohet dhe të kthehet në një festë mbarëshqiptare, mbasi është më tradicionale se të kremtet fetare. Dita e Verës, ashtu sikurse edhe Viti i Ri, është festë e të gjithë shqiptarëve, pa dallim krahine, ideje, bindjesh, përkatësish, apo besimi fetar. Gjatë shekujve festimi i Ditës së Verës erdhi duke u zbehur. Aq sa diku ajo u harrua krejtësisht e nuk kremtohej më. Ndërsa në Elbasan ajo nuk u zbeh kurrë. Nëse Dita e Verës erdhi deri në ditët tona merita i takon kryesisht Elbasanit. Tani ajo është zyrtarisht një festë kombëtare.

Elbasani ende shumë ndryshe nga pjesa tjetër e Shqipërisë, është vendi ku Dita e Verës ndjehet dhe përjetohet në kuptimin më të plotë të fjalës.

Komisionet dhe Institutet

Akademiku Anastas Angjeli takon Presidentin e Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit



Më 13 mars 2026, në ambientet e Akademisë Kombëtare të Shkencave të Azerbajxhanit u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe drejtuesve të Akademisë Kombëtare të Shkencave e Azerbajxhanit, i kryesuar nga Presidenti i Akademisë, akademiku Isa Habibbeyli.

Në takim morën pjesë akademiku Anastas Angjeli dhe prof. Arben Cici, anëtar i Komisionit të përhershëm të Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Delegacioni shqiptar shqërohej nga Ambasadori Republikës së Shqipërisë në Azerbajxhan, dr. Besart Kadia dhe Këshilltari i Ambasadës z. Dorian Koçi.

Gjatë takimit u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit shkencor dhe institucional ndërmjet dy akademive, në vijim të bisedimeve të zhvilluara në janar 2026. Të dy bashkëbiseduesit shprehën vullnetin për nënshkrimin sa më parë të një marrëveshjeje bashkëpunimi, që synon nxitjen e shkëmbimeve akademike dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore në fushat me interes të ndërsjelltë.

Ky hap i rëndësishëm i bashkëpunimit kulturor dhe shkencor kontribuon në forcimin e marrëdhënieve të shkëqyera mes Shqipërisë dhe Azerbajxhanit

Komisioni i përhershëm i ekonomisë zhvilloi forumin me temë: Turizmi në epokën digjitale: Shqipëria drejt një të ardhmeje të qëndrueshme dhe teknologjike!



Sot ne 24 mars 2026, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua forumi kombëtar me temën: "Turizmi në epokën digjitale: Edukimi dhe zhvillimi i aftësive për një të ardhme të qëndrueshme në Shqipëri". Ky aktivitet u organizua nga Komisioni i përhershëm i ekonomisë në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm të matematikës dhe informatikës, duke bërë bashkë kërkues shkencorë, akademikë dhe ekspertë të industrisë.

Forum "Turizmi në epokën digjitale" u organizua dhe u moderua nën drejtimin e akad. Anastas Angjelit, kryetar i Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë dhe prof. dr. Klodiana Goricës. Angazhimi i tyre ishte kyç në bashkërendimin e forcave midis dy komisioneve të Akademisë së Shkencave, duke krijuar një platformë që nxit bashkëpunimin ndër-institucional dhe dialogun midis kërkimit shkencor dhe nevojave reale të tregut.

Ky forum shërbeu si një platformë unike bashkëpunimi, duke bërë bashkë autoritetet më të larta të akademisë dhe institucioneve kyçe në vend. Diskutimet mbledhën përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), e cila u vlerësua si një mbështetëse kryesore e kërkimit shkencor përmes financimit të projekteve që lidhin shkencën me praktikën. Pjesë e tryezës ishin gjithashtu kërkues shkencorë dhe ekspertë të shumtë, përfaqësues të Universitetit të Tiranës, Universitetit Mesdhetar, nga industria e turizmit dhe hotelërisë, si dhe drejtues të institucioneve publike, si Muzeu Kombëtar, duke krijuar një dialog


gjithëpërfshirës mbi integrimin e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë në trashëgiminë dhe ekonominë tonë.

Konkluzionet kryesore të Forumit:

1. Mbyllja e hendekut të aftësive: Ekziston një nevojë urgjente për të adresuar diferencën midis arsimit akademik dhe kërkesave reale të industrisë së turizmit për aftësi digjitale (kompetencat SMART).
2. Ristrukturimi i kurrikulave: Analiza e dinamikave të tregut të punës duhet të shërbejë si bazë për përditësimin e programeve mësimore në universitete.
3. Inovacioni në trashëgimi dhe prodhim: Inteligjenca artificiale dhe digjitalizimi ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për transformimin e muzeve dhe integrimin e sistemeve të qëndrueshme ushqimore lokale në ofertën turistike.
4. Bashkëpunimi trigjithësor: Suksesi i turizmit të qëndrueshëm varet nga dialogu i hapur dhe i vazhdueshëm midis akademisë, industrisë dhe institucioneve publike. Shqipëria ndodhet në një moment kyç për të orientuar turizmin drejt një modeli konkurrues që shfrytëzon në plotësi potencialin e epokës digjitale.



Komisioni i përhershëm i mjekësisë zhvillua tryeza shkencore për prezantimin e librit “Shëndeti dhe sëmundja” të prof. dr. Eduard Kakarriqit



Takimi u mbajt më 26 mars 2026 me organizimin e Komisionit të përhershëm të mjekësisë, me synimin për të vlerësuar kontributin e veprës në fushën e shëndetit publik dhe epidemiologjisë. Në këtë tryezë morën pjesë anëtarë të kryesisë, si dhe profesionistë të shquar të mjekësisë nga vendi dhe Kosova.

Kryetari i Komisionit të përhershëm të mjekësisë, akad. Genc Sulçebe, fillimisht foli për karrierën e shkëlqyer të prof. Kakarriqit si mjek dhe pedagog universitar në fushën e mjekësisë, i angazhuar në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor për një periudhë të gjatë. Ai e vlerësoi si nga figurat e shquara të shkencave mjekësore shqiptare që ka dhënë kontributin prej disa dekadash veçanërisht në fushën e mikrobiologjisë dhe vaksinimit, për të motivuar të gjithë shqiptarët, duke kryer ndër të parët vaksinën për të parandaluar sëmundjen COVID-19.

Më tej ai e vlerësoi prof.dr. Kakarriqin si autorin e veprës “Shëndeti dhe sëmundja – vështrim gjithëpërfshirës filozofik dhe epidemiologjik”, një libër voluminoz me rreth 1100–1200 faqe. Akad. Sulçebe e cilësoi veprën si një ndërmarrje ambicioze dhe të rrallë në literaturën mjekësore shqiptare. Sipas tij, libri synon të trajtojë në mënyrë të integruar dy dimensione themelore të mjekësisë: atë filozofik dhe atë epidemiologjik.

Ai theksoi se autori shkon përtej një qasjeje të ngushtë biomjekësore, duke ndërtuar një analizë të gjerë që përfshin konceptet filozofike të shëndetit dhe sëmundjes, teoritë

bashkëkohore si natyralizmi dhe normativizmi, evolucionin historik të këtyre koncepteve, si dhe dimensionet biologjike, sociale, psikologjike dhe etike. Në këtë kontekst, libri u vlerësua si një sintezë e rrallë ndërdisiplinore, ku mjekësia trajtohet jo vetëm si shkencë biologjike, por edhe si shkencë sociale dhe humaniste. Dimensioi epidemiologjik i veprës e bën atë një udhëzues të vlefshëm edhe për politikëbërjen shëndetësore, duke ofruar analiza të bazuara në faktorë biologjikë, mjedisorë, socialë dhe kulturore, tha akad. Sulçebe.

Prof. dr. Naser Ramadani vlerësoi në këtë vepër trajtimin e marrëdhënies komplekse midis shëndetit dhe sëmundjes, duke ofruar një perspektivë të thellë filozofike dhe epidemiologjike. Ai nënvizoi se vepra ndihmon në kuptimin e shëndetit përtej kufijve të ngushtë mjekësorë, duke e konsideruar atë si një vlerë themelore që ndikohet nga faktorë socialë, mjedisorë dhe kulturorë. Sipas tij, libri e trajton shëndetin si një mekanizëm dinamik, i cili ndryshon gjatë jetës dhe që, në kushtet e devijimit nga baraspesha e funksionimit normal të trupit dhe mendjes, mund të kalojë drejt sëmundjes përmes ndërveprimit të faktorëve etiologjikë kompleksë.

Në reflektimet mbi përvojën personale dhe akademike prof.dr. Albana Fico vlerësoi qasjen origjinale të autorit në trajtimin e koncepteve dhe përdorimin e një strukture të veçantë analitike, e cila ndihmon në kuptimin më të mirë dhe aplikimin praktik të ideve të paraqitura në libër, përfshirë edhe dimensionin klinik.

Pjesëmarrës të tjerë në diskutim theksuan vlerën e librit në drejtim të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit mbi sjelljet që promovojnë shëndetin dhe ato që e dëmtojnë atë. U vlerësua gjithashtu pasuria e burimeve shkencore të përdorura, me mbi 1500 referenca dhe një strukturë të ndërtuar në 46 kapituj, që reflekton një punë të gjerë kërkimore dhe akademike.

Në këtë veprimtari u prezantua varianti E-Book, i disponueshëm online nga Shtëpia Botuese e Librit Shkollor e Re. Versioni PDF përmban të dy vëllimet e librit, me gjithsej 1178 faqe dhe rreth 124 MB.

Në përfundim, pjesëmarrësit në këtë tryezë shkencore evidentuan rëndësinë e veprës "Shëndeti dhe sëmundja" të prof. dr. Eduard Kakarriqit si një kontribut i vyer në mendimin mjekësor shqiptar dhe si një pikë referimi për studiuesit, profesionistët e shëndetësisë dhe politikëbërësit.



U mbajt mbledhja e Komisionit të Fizikë-Kimisë



Takimi u zhvillua më 11 mars 2026 me pjesëmarrjen e akad. emeritus Floran Vila; akad. emeritus Rexhep Mejdani; akad. emeritus Dhimitër Haxhimihali; akad. Mimoza Hafizi (online); akad. Besnik Baraj; akad. Ilirjan Malollari; prof. Dr. Elda Marku; prof. dr. Fatos Ylli; prof. dr. Petrit Zorba; prof. dr. Rozana Troja; prof. as. Klaudio Peqini; prof. dr. Partizan Malkaj; prof. dr. Elida Bylyku; prof. as. Florian Mandrija

Mbledhja u mbajt me synim përgatitjen e disa aktiviteteve të vitit 2026, diskutimin mbi projektet dhe problematika të ndryshme. Kryetari i Komisionit akad. Floran Vila i ftoi me radhë drejtuesit e njësive të kërkim studimit dhe Institutit kombëtar të fizikës (IKF) që janë në këtë komision të raportojnë për planet dhe përgatitjet që po bëhen në lidhje me aktivitetet që janë propozuar për vitin 2026.

Akad. Ilirian Malollari, drejtues i Njesisë së Energjive të Rinovueshme paraqiti çështje të organizimit të konferencës ndërkombëtare "Strategjia për Adoptimin e Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri", si dhe të workshopit me temën "Kalimi në energjinë e rinovueshme është një hap kritik drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe luftimit të ndryshimeve klimatike" që pritet të mbahet në nëntor 2026, në bashkëpunim me AKKSHI-n.

Akad. Besnik Baraj, drejtues i Njesisë së pasurive ujore bëri një prezantim të të organizimit

të workshopit "Urban Stormwater management approaches for Albania" në bashkëpunim me universitetin "Boku" dhe Universitetin Politeknik të Tiranës. Ai paraqiti dhe programin e punës për webinarin nga prof. Zydi Teqja me temën "Menaxhimi i ujit të stuhive në epokën e urbanizimit". Me tej u diskutua konferenca ndërkombëtare mbi mjedisin, ujin, ajrin dhe tokën, që do të mbahet në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; workshopin mbi ujin dhe mjedisin; konferencën e IV Ndërkombëtare mbi Shëndetin Publik dhe Mjedisin dhe për webinare të ndryshme e workshope, në lidhje me 7 projektet e Njesisë.

Akad. Mimoza Hafizi, drejtuese ekzekutive e Institutit Kombëtar të Fizikës foli për organizimin e veprimtarisë "Java e shkencës/Java e fizikës" dhe konkursin kombëtar me video Younivers, si dhe promovimin e veprës së prof. Rexhep Meidanit, duke përfshirë dhe konferencën në lidhje me kolanën e 4 veprave në fushën e fizikës.

Akad Malollari, prof. dr. Ylli, prof.dr. Petrit Zorba diskutuan lidhur me organizimin dhe realizimin e veprimtarive të Komisionit, duke përfshirë sa më shumë departamente, institute dhe qendra shkencore.

Nw fund, akad. Vila paraqiti dy veprimtaritë e propozuara nga Komisioni i fizikë-Kimisë: "Nga auditori në tregun e punës" dhe "Efikasiteti i shërbimeve meteorologjike". U përcaktuan grupet e punës që do të merren me organizimin e tyre, ku u dhanë edhe idetë garantimin e cilësisë shkencore, transparencës efikasitetit dhe llogaridhënies institucionale, si dhe përthithjen e studenteve nga tregu i punës.

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë zhvilloi tryezën shkencore “Frederik Rreshpja në poezi e përjetësi”



Më datën 3 mars 2026, në sallën “Akademikët” (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) u mbajt tryeza shkencore “Frederik Rreshpja në poezi e përjetësi”, organizuar nga Departamenti i Studimeve Letrare (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë). Në fjalën e përshëndetjes të mbajtur nga akademik Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë u nënvizua rëndësia e mbajtjes së kësaj tryeze në rasë të njëzetvjetorit të ndarjes nga jeta të Frederik Rreshpjes (1940-2006), lirikut "të pangjashëm" që la gjurmë me një krijimtari të veçantë poetike. Në kumtesat e mbajtura u trajtuan aspekte qenësore të kësaj krijimtarie, me nënvizime dhe të motiveve që përmbahen në të, duke u analizuar dhe në elemente të përmbajtjes dhe të kompozimit.

Kumtuan në këtë tryezë shkencore studiuesit Evalda Paci (Symposium in memoriam celebris poëtae et auctoris), Xhahid Bushati (Disa këndvështrime për poetin Frederik Rreshpja), Virion Graçi (Frederik Rreshpja, poezi e përjetësi), Arben Prendi (Estetizimi i dhimbjes, vetmisë, fatit dhe vdekjes në poezinë e Frederik Rreshpjes), Viola Isufaj (“Les Lions Brisés de l’Enfance” - zgjedhjet leksikore dhe stilistike të A. Zotos në përkthimin e poezisë së Rreshpjes në gjuhën frënge), Rovena Vata (Dhimbja dhe vetmia në perceptimin poetik të Frederik Rreshpjes), Neli Naço (Hipostazat e vetmisë në poezinë e Frederik Rreshpjes).

Në përmbyllje të kësaj tryeze u ndanë kujtime të veçanta nga jeta dhe veprimtaria e Frederik Rreshpjes, krijimtaria poetike e të cilit është ribotuar në një pjesë të konsiderueshme dhe në vitet e fundit.

U zhvillua tryeza shkencore me temën “Gjeografia përtej stigmës si shkencë/disiplinë e fakteve dhe informacionit”



Takimi u mbajt më 24 mars 2024, me organizmin e Njesisë së përkohshme të kërkimeve gjeografike (NJKGJ), pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Kjo tryezë çeli serinë e aktiviteteve të shumta shkencore, të planifikuara për vitin 2026 nga NJKGJ, ku morën pjesë akademikë e studiues të gjeografisë e të fushave të afërta; studiues të angazhuar me kurrikulat; trajnues të mësuesve dhe mësues me përvojë.

Drejtimi i takimit u bë nga prof. asoc. Merita Karaguni dhe prof. asoc. Jostina Dhimitri.

Prof. asoc. Karaguni falënderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët dhe e vlerësoi takimin të domosdoshëm për trajtimin e çështjeve me rëndësi, që lidhen me identitetin shkencor të gjeografisë dhe vendin e saj në politikat arsimore dhe institucionale.

Akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të ASHSH-së, përshëndeti në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ai tha se ASHSH-ja e vlerëson nismën për të rishqyrtuar vendin dhe rolin e gjeografisë në sistemin tonë arsimor dhe në kërkimin shkencor bashkëkohor, që synon forcimin e profilit shkencor të disiplinave tona, si dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe të kërkimit shkencor në vend.

Akad. Hoxha e vuri theksin në domosdoshmërinë e diskutimeve mbi identitetin shkencor të gjeografisë në kurrikulën shkollore dhe mbi vendin e saj në politikat arsimore dhe institucionale, duke shkuar përtej perceptimit e paragjytimeve si një disiplinë përshkruese, e lidhur me memorizimin e fakteve dhe të dhënave. Diskutimet e kësaj tryeze lidhen drejtpërdrejt me formimin e brezave të rinj dhe me aftësinë e tyre për të kuptuar dhe përballuar sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm, të ndryshimeve klimatike dhe të transformimeve socio-ekonomike. -tha akad. Hoxha.

Prof. dr. Perikli Qiriazhi, drejtues i Njesisë së përkohshme të kërkimeve gjeografike, falënderoi Kryesinë e Akademisë së Shkencave për mbështetjen e NJKGJ-së, që u miratua në shkurt 2025, si strukturë e qëndrueshme kërkimore në fushën e gjeografisë. Më tej paraqiti një sërë aktiviteteve shkencore dhe arritje të Njesisë gjatë vitit 2025, ku veçoi organizimin e dy konferencave të mëdha shkencore ndërkombëtare si: forumi “Arkitektura e peizazhit në Shqipëri: sfida e potenciale”, që hapi një dritare të re të studimeve gjeografike, në bashkëpunim me Departamentin e Hortikulturës dhe “Konferenca 2025: Qytetet pas tranzicionit”, ku u referuan 160 studime, 130 nga Europa e Bota dhe 30 studime nga Shqipëria e Kosova. Ky kuvend i madh gjeografik, për katër ditë (23-26 shtator 2025), e ktheu Tiranën në “qendër të gjeografisë europiane”. Ajo na hapi horizont mbi problemet e sotme europiane të qyteteve post-socialiste, për rrugët dhe metodat e reja të studimit të tyre.

Prof. dr. Qiriazhi vlerësoi edhe veprimtaritë e tjera të realizuara gjatë 2025-s, që kanë dhënë ndihmesë në studime të thelluara gjeografike dhe në disa shkencë natyrore, sociale, ekonomike, politike e më gjerë.

Në dy seancat e tryezës shkencore, referuesit prof. asoc. Merita Karaguni, prof. asoc. Fitim Humolli, prof. asoc. Valbona Duri, prof. asoc. Jostina Dhimitri, dr. Shkëlqim Sirika u përqendruan në disa çështje si: problemet e kurrikulave dhe të procesit mësimor gjeografik, në qasje analitike përmes studimit të rasteve në programet/tekstet shkollorë; identiteti kulturor dhe rritja e shkallës së ndërgjegjësimit për problematikat lokale e globale, dinamikat e tyre; konceptet gjeografike dhe marrëdhëniet me konceptet e tjera; hartimi i kurrikulave dhe teksteve mësimore etj. Gjithashtu, ligjëruesit e vunë theksin në pozicionin e gjeografisë në epokën e digitalizimit e novacionit teknologjik, ndikimin e IA-së në të ardhmen e gjeografisë si shkencë dhe si disiplinë shkollorë, duke ngritur çështje të tilla si: sa reflektohen sfidat e shekullit XXI mbi zhvillimin e qëndrueshëm, transformimet teknologjike e digjitale e ndërvarësitë globale në kurrikulat e gjeografisë në arsimin parauniversitar e më gjerë.

Ne fund, u bënë analiza, diskutime dhe konkluzione shkencore për problemet komplekse që lidhen me konceptimin rëndësor dhe vlerat e gjeografisë si shkencë e disiplinë mësimore në arsimin parauniversitar, universitar dhe pasuniversitar, si dhe u diskutua bashkëpunimi me Njësinë për realizimin e projekteve të miratuara për vitin 2026 dhe u propozuan projekte të tjera, në kuadër të bashkëpunimeve ndër-institucionale.

U zhvillua webinar-i me temën: “Menaxhimi i ujit të stuhive në epokën e urbanizimit: Sfida për Shqipërinë”



**Projektim qyteti me
prioritet makinat**

Më 26 mars 2026 u zhvillua webinar-i me temën: “Menaxhimi i ujit të stuhive në epokën e urbanizimit: Sfida për Shqipërinë”. Aktiviteti u organizua nga Njësia “Pasuritë ujore” me mbi 50 pjesëmarrës nga fusha të ndryshme akademike dhe profesionale, ku solli në vëmendje perspektiva të reja mbi menaxhimin e ujërave, ndikimin e urbanizimit dhe rolin e arkitekturës së peizazhit në përballimin e krizave mjedisore.

I ftuar në këtë webinar ishte prof. dr. Zydi Teqja, i cili prezantoi dhe diskutoi strategjitë për integrimin e hapësirave të gjelbra, sistemeve blu-gjelbër dhe infrastrukturës së qëndrueshme të drenazhimit urban. Ai trajtoi çështje kyçe që lidhen me ndikimin e urbanizimit në rritjen e rrezikut të përmbytjeve, duke theksuar rolin e arkitekturës së peizazhit dhe infrastrukturës blu-gjelbër në menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave.

U diskutuan, gjithashtu, qasje moderne për transformimin e hapësirave urbane në sisteme më rezistente dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve klimatike.

Aktiviteti u karakterizua nga diskutime të shumta dhe interaktive, ku pjesëmarrësit nga institucione të ndryshme kërkimore - shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë ngritën dhe adresuan një sërë problematikash konkrete që lidhen me situatën aktuale në Shqipëri, duke reflektuar interesin e lartë dhe rëndësinë e temës për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

“Etnotoponomastikë: shtigje kërkimi”, ditë studimore në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë



Veprimtaria u mbajt nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 13 mars 2026, në kuadër të ditëve studimore me temën “Etnotoponomastikë: shtigje kërkimi”.

Me këtë rast, studiues të fushave të ndryshme të albanologjisë u mbledhën për të diskutuar mbi studimin dhe dokumentimin e toponimisë dhe mikrotoponimisë. Në kuadër të këtij takimi referuan studiueset prof. asoc. dr. Merita Sauku Bruci, dr. Ledi Shamku Shkreli dhe dr. Valbona Sinanaj.

Veprimtaria u hap me fjalën përshëndetëse të prof. asoc. dr. Evalda Paci, përgjegjëse e Departamentit të Studimeve Letrare, e cila theksoi rëndësinë e projektit studimor për renditjen elektronike dhe digjitalizimin e fondit të toponimeve të ruajtura në arkivat e instituteve albanologjike. Ajo nënvizoi se ky projekt paraqet një qasje ndërdisiplinore dhe synon vlerësimin e pasurisë së madhe dokumentare që përmban kartoteka e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Projekti, i njohur me siglën “Thirre vendin tënd”, i cili është prezantuar edhe në një konferencë ndërkombëtare të zhvilluar një vit më parë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ka hyrë tashmë në vitin e dytë të ecurisë së tij dhe realizohet në bashkëpunim me studiues nga institutet e Albanologjisë.

Në vijim, aktivitetin në emër të kryesisë së Akademisë së Shkencave e përshëndeti Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. asoc. Gëzim Hoxha, i cili theksoi rëndësinë e studimeve mbi toponiminë dhe mikrotoponiminë si pjesë e trashëgimisë gjuhësore dhe kulturore. Ai nënvizoi se këto studime ruajnë gjurmë të historisë së vendbanimeve, të mënyrës së jetesës dhe të kujtesës kolektive të

komuniteteve, duke kërkuar një qasje ndërdisiplinore që ndërthur gjuhësinë, historinë, antropologjinë, etnologjinë, gjeografinë kulturore dhe arkeologjinë.

Në referimin e saj, prof. asoc. dr. Merita Sauku Bruci u ndal në zhvillimin e projektit dhe në zgjerimin e qasjes kërkimore përtej digjitalizimit të fondit toponimik, duke përfshirë edhe dimensionin territorial dhe përvojat kërkimore të studiuesve. Në këtë kuadër, ajo trajtoi edhe çështjen e fjalës përtej toponimit, duke u ndalur në rastin e mikrotoponimit “Bota e Bardhë”, si një shembull që dëshmon mënyrën se si emërtimet vendore mbartin kuptime gjuhësore, kulturore dhe historike të lidhura me hapësirën dhe kujtesën e komunitetit.

Dr. Ledi Shamku Shkreli, nga Laboratori i Antropologjisë Gjuhësore pranë Institutit të Antropologjisë, paraqiti kumtesën me titullin “Kur një shkurre e vogël shkruhet me germë të madhe: Rrushkulli në hapësirat e kujtesës”, ku trajtoi mënyrën se si elemente të natyrës shndërrohen në shenja identitare dhe bartëse të kujtesës kolektive.

Ndërsa dr. Valbona Sinanaj referoi mbi temën “Mikrotoponimi ‘Këneta e Zezë’ në Strum të Roskovecit”, duke analizuar aspektet historike, gjuhësore dhe kulturore të këtij emërtimi lokal dhe duke theksuar rëndësinë e mikrotoponimeve si burim i vlefshëm për studimin e marrëdhënies së njeriut me mjedisin dhe territorin.

Veprimtaria solli në vëmendje rëndësinë e studimeve mbi etnotoponomastikën si një fushë kërkimi që ndihmon në kuptimin më të thellë të marrëdhënies mes gjuhës, territorit dhe kujtesës kulturore.



Promovime dhe botime

U promovua libri “Sali Vranishti kapedani që nuk i mbylli sytë as në bronz”



Veprimtaria promovuese u organizua sot, më 18 mars 2026, nga Komisioni i përhershëm i arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), në bashkëpunim me Institutin e Historisë. Promovimi u mbajt me synimin për të shpalosur kujtesën historike dhe shpirtërore të kombit shqiptar rreth figurës së Heroit të Popullit, Sali Vranishti. Akad. Hamit Kaba në fjalën e hapjes shprehu falënderimet për organizatorët dhe pjesëmarrësit dhe theksoi se Sali Vranishti është një figurë e rëndësishme historike, që në mendjet dhe zemrat e popullit është kthyer në një figurë legjendare e mitike.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Vasil Tole, kryetar i Komisionit të përhershëm të arteve pranë ASHSH-së, vuri në dukje rëndësinë e librit si dëshmi të jetës dhe aktivitetit patriotik të Vranishtit. Ai e prezantoi Vranishtin si njeriun këngë, ndërsa e vlerësoi figurën e tij në këngët e rrëfenjat popullore si të prekshme lidhur me jetën dhe aktivitetin e tij patriotik për Shqipërinë. Ai u shpreh se Sali Vranishti është vlerësuar me epitete që reflektojnë vlerësimin autentik të popullit, jashtë klasifikimeve formale shoqërore dhe akademike. Akad. Tole theksoi se në këngët e popullit përfshihet gjithmonë kategoria e më të shquarve dhe kënga popullore për Sali Vranishtin mbetet një monument i pavdekësisë.

Akad. Shaban Sinani u shpreh se ky është një libër polifonik që ka ritestuar mendimin shqiptar për këtë figurë në një periudhë kur shumë vlera dhe trashëgimi, jo në mënyrë

objektive, por për shkaqe të tjera herë pas here janë vënë në pikëpyetje. Mos ju duket aspak e çuditshme shtoi ai se dhe figura e Sali Vranishtit, kapedani i luftës së Vlorës, një prej epiqendrave të asaj qëndrese, dhe një figurë kombëtare që nderon Shqipërinë dhe lirinë e saj, e ka kaluar këtë test në një kohë të vështirë. Figurën e Sali Vranishti e kanë shënjuar dhe vendosur në histori 110 vite krijimtari për të. Për një figurë, krijimtaria bëhet për ta mbajtur mes nesh. Akad. Sinani theksoi se janë të pakta figurat e historisë shqiptare, por edhe në Ballkan, që kënga t' u jetë dhuruar edhe kur kanë qenë gjallë.

Më tej, për figurën e Vranishtit folën akad. Hamit Kaba, z. Luan Rama dhe prof. asoc. Mareglen Kasmi, të cilët duke iu referuar dokumenteve historike e vlerësuan Sali Vranishtin si simbol dhe figurë të shquar të kujtesës kombëtare për qëndrimet e tij ndaj osmanëve dhe aktivitetin e tij në periudhën e shpalljes së Pavarësisë.

Në mbyllje të veprimtarisë, autori Arben Saliu falënderoi kryetarin e Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushin, miqtë e familjes dhe mentorët. Ai theksoi vështirësinë dhe rëndësinë e dokumentimit të jetës së gjyshit të tij, që nëpërmjet dëshmive dhe fotografive të këtij libri të mund të ruhet kujtesa historike dhe shpirtërore për brezat e rinj.



U promovua në Tiranë libri “Kur heshtja flet” i autorit Ahmet Shala Gjinushi: Gjkata speciale ka humbur legjitimitetin, ajo po vepron jashtë mandatit të marrë nga Kuvendi i Kosovës.



Vepra u promovua më 24 mars 2026, në Hotel Plaza, veprimtari e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Përmbajtja e veprës “Kur heshtja flet” e Ahmet Shalës është një rrëfim personal dhe reflektim mbi luftën e Kosovës, sfidat e saj dhe realitetin aktual me të cilin përballen ish-udhëheqësit e UÇK-së në procesin gjyqësor në Hagë.

Veprimtaria u përshëndet nga kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi. Ai falënderoi pjesëmarrësit dhe vlerësoi iniciativën e autorit për të sjellë një dëshmi të sinqertë mbi përjetimet gjatë proceseve gjyqësore më të debatueshme në planin politik dhe juridik. Akad. Gjinushi vuri në dukje se libri nuk përbën thjesht një përmbledhje kujtimesh, por një reagim ndaj padrejtësive aktuale në vazhden e padrejtësive historike ndaj Kosovës, si dhe një analizë të argumentuar mbi arsyet politike që çuan në ngritjen e këtij procesi.

Më tej, kryetari i ASHSH-së theksoi se çështja e përcaktimit të agresorit dhe viktimës

është gjykuar tashmë historikisht, e ky “gjyq” u fitua që në vitin 1999 kur Kosova fitoi mbështetjen e NATO-s dhe të botës demokratike. Ai u shpreh se procesi gjyqësor në fjalë u ngrit në një kontekst politik, nga një institucion politik si Këshilli Europës dhe se me rënien e akuzës për trafik organesh gjykata speciale ka humbur legjitimitetin.

Në përfundim të fjalës së tij, akad. Gjinushi vlerësoi mesazhet e librit, si një thirrje e obligim edhe për institucionet shkencore dhe akademike për të mbrojtur të vërtetën historike nga çdo deformim, perballje e trajtim të sajë sipas interesave të politikës së ditës.



Kryetarja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Justina Shiroka-Pula foli për rëndësinë që ka vepra si shprehje e reagimit ndaj padrejtësive dhe nevojës që institucionet akademike të mos heshtin përballë zhvillimeve të tilla.

Më tej, duke kujtuar përvjetorin e bombardimeve të NATO-s mbi ish-Jugosllavinë, z. Taulant Balla përgëzoi autorin dhe organizatorët për promovimin e mbajtur në një datë kuptimplotë. Ai theksoi se reflektimi mbi të kaluarën dhe përgjegjësia për të tashmen janë thelbësore, duke ngritur shqetësimin për perceptimet dhe zhvillimet aktuale që lidhen me UÇK-në dhe proceset gjyqësore në Hagë.

Historiani prof. dr. Paskal Milo u ndal te vlera e veprës, duke theksuar se rëndësia e librit

qëndron në mjeshtërinë e autorit për të trajtuar temat dhe për të përcjellë mesazhe me peshë historike dhe shoqërore. Ai vlerësoi librin “Kur heshtja flet” si një kontribut të rëndësishëm në debatin publik dhe akademik.

Për librin “Kur heshtja flet” të autorit Ahmet Shala mbajten ligjërata edhe përfaqësues të jetës akademike, politike dhe publike, të cilët e vlerësuan ndër të tjera, si një dëshmi të guximshme dhe një kontribut të rëndësishëm në mbrojtje të së vërtetës historike. Diskutimet theksuan rëndësinë e reagimit institucional dhe shoqëror ndaj sfidave që lidhen me interpretimin e historisë, si dhe nevojën për të ruajtur dhe mbrojtur vlerat e luftës për liri dhe dinjitet

Ngjarja u përmbyll me fjalën përsëritëse të autorit dhe mesazhe nga të pranishmit për unitet, angazhim dhe përgjegjësi, duke theksuar se e ardhmja ndërtohet mbi të vërtetën dhe veprimin e përbashkët.



Promovohet libri më i ri i shkrimtarit Namik Dokle “Atje ku dielli lind dy herë – Saga e Gorës”



Në 80-vjetorin e tij të lindjes, shkrimtari dhe politikani Namik Dokle bëri bashkë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë personalitete të kulturës, shkencës dhe politikës, me rast promovimin e librit më të ri “Atje ku dielli lind dy herë – Saga e Gorës”.

Znj. Majlinda Toçi, drejtoreshë e komanduar e Bibliotekës Kombëtare, në fjalën e hapjes të veprimtarisë, u shpreh e emocionuar për pjesëmarrjen e personaliteteve të larta në promovimin e veprës dhe e vlerësoi shkrimtarin Namik Dokle si një nga zërat më të veçantë të letrave shqipe. Ajo e paraqiti veprën e tij më të re “Atje ku dielli lind dy herë – Saga e Gorës”, si një rrëfim të gjerë letrar mbi historinë, duke përfshirë traditat dhe jetën e banorëve të krahinës së Gorës e duke ndërthurur kujtesën historike me rrëfimin artistik dhe dimensionin njerëzor të personazheve.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave akad. Vasil Tole, dhe njëherësh kryetar i Komisionit të Përhershëm të Arteve pranë ASHSH-së, bashkorganizator i kësaj veprimtarie, mbajti një fjalë përshëndetëse, ku vlerësoi shkrimtarin Dokle si një personalitet të rëndësishëm të jetës kulturore e shkencore të Shqipërisë.



Akad. Tole paraqiti më tej një vështrim estetik të veprës së Dokles, duke e përshkruar shkurt si trilogji që ka si bosht karakterin historik e legjendar, rrëfimin për fatin dhe ndodhitë e një familjeje, të një fisi apo grupi etnik gjatë disa brezave. Duke e nisur nga ky këndvështrim, saga zakonisht mbështetet në një bazë historike të qartë, të mirëpërcaktuar, duke gërshetuar elementët realë me elementët legjendarë. Ai theksoi se “Saga e Gorës” është tashmë një shembull i bukur dhe i pasur që përfshin artistikisht jetën e Gorës për një periudhë kohore që shkon edhe përtej përmasës së kujtesës njerëzore. Ajo është vazhdim i kujtesës së të parëve të tij të cilën shkrimtari Dokle e sjell në jetë përmes përpunimit artistik, përmes narratives së fuqishme, përmes folklorit dhe frazeologjisë tipike të zonës, përmes traditave gojore dhe sistemore intelektuale.

Në fund të fjalës së tij, akad. Tole e vlerësoi librin e Dokles si një monument letrar që shpaloset me ngjyra të gjalla nga pena e shkrimtarit me një mozaik të gjerë narrativ, ku kultivohen e zhvillohen vlerat e shtresave sociale, përkufizime të psikologjisë njerëzore dhe të zhvillimit të jetës në një kohë të caktuar. Ky roman sjell një dimension të ri të rrëfimit historik, duke shërbyer si një pikë referimi për studimet e mëtejshme për historinë, kulturën dhe traditat e kësaj krahine.

Për vlerat estetike dhe mesazhet e veprës mbajtën ligjërata edhe studiuesi Behar Gjoka, kritiku dhe publicisti Agim Baçi.

Në fund, shkrimtari Dokle i falënderoi të gjithë të pranishmit, miqtë dhe ligjëruesit për vlerësimin e veprës, duke vlerësuar edhe rrugëtimin e përbashkët që ka bërë me ta në fushën e publicistikës dhe të krijimtarisë. Gjithashtu, ai falënderoi shtëpitë botuese “Toena” e “Onufri”. Në mënyrë të veçantë, ai falënderoi kryesinë e ASHSH-së, Komisionin e Arteve në Akademinë e Shkencave, kryetarin e këtij komisioni zv. kryetarin e ASHSH-së akad. Vasil Tole për organizimin e këtij aktiviteti.



U promovua botimi “Studime albanologjike në indoeuropeanistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti” në nderim të prof. Bardhyl Demiraj



Më 27 mars 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua veprimtaria promovuese e botimit shkencor Festschrift “Studime albanologjike në indoeuropeanistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti”, kushtuar prof.dr. Bardhyl Demiraj. Aktiviteti u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, në bashkëpunim me Komisionin e përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përshëndeti akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, i cili e vlerësoi prof. dr. Bardhyl Demirajn si një ndër përfaqësuesit më të spikatur të studimeve albanologjike në hapësirën akademike europiane. Ai vuri në dukje veprimtarinë e tij të rëndësishme si gjuhëtar dhe filolog në Universitetin “Ludwig Maximilian” të Mynihut, si dhe rolin e tij në drejtimin e njësisë së shqipes në një prej qendrave më të rëndësishme të albanologjisë në Europë.

Akad. Hoxha nënvizoi se vëllimi i botuar përbën jo vetëm një nderim për figurën e prof. Demirajt, por edhe një pasqyrë të zhvillimeve bashkëkohore të studimeve albanologjike në kontekstin europian. Ai vlerësoi gjithashtu kontributin e tij si një urë lidhëse midis albanologjisë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare, duke theksuar se është nder për Akademinë që ai është pjesë e saj si akademik i jashtëm.

Në përfundim, ai përgëzoi përgatitësit e vëllimit: prof. dr. Anila Omari, akad. Shaban Sinani dhe Ledio Hala, si dhe të gjithë autorët pjesëmarrës, duke e cilësuar botimin si një dëshmi të qëndrueshme të vlerësimit të komunitetit shkencor për veprën dhe personalitetin e prof. Bardhyl Demiraj.

Në vijim, prof. Seit Mansaku e cilësoi vëllimin si një arritje të rëndësishme shkencore, duke vlerësuar njëherazi bashkëpunimin e tij shumëvjeçar me prof. dr. Demiraj dhe kontributin e hartuesve të botimit.



Bashkëhartuesja e vëllimit prof. dr. Anila Omari vlerësoi botimin kremtues, i cili nderon një nga figurat më të spikatura të albanologjisë bashkëkohore. Ajo vuri në dukje se vëllimi është realizuar me pjesëmarrjen e studiuesve nga fusha të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, duke përbërë një dëshmi të gjerë të ndikimit shkencor të prof. dr. Demirajt. Po ashtu, ajo nënvizoi se botimi pasqyron zhvillimet më të fundit në studimet albanologjike dhe indoeuropiane, përmes një game të larmishme qasjesh teorike dhe metodologjike. Më tej, prof. dr. Omari vlerësoi fjalën hyrëse të kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi dhe një shkrim laudativ nga akad. Shaban Sinani, kushtuar veprimtarisë shkencore të prof. Demiraj. Në përmbajtjen e veprës përfshihen 25 artikuj shkencorë, të strukturuar sipas fushave kryesore të albanologjisë.

Akad. Shaban Sinani foli për traditën e Akademisë së Shkencave për botime të këtij formati, duke e vlerësuar veprën si një ndër kontributet më të rëndësishme të viteve të fundit në nderim të figurave të shquara të albanologjisë. Ai theksoi se botimi pasqyron në mënyrë dinjitoze veprën dhe ndikimin shkencor të prof. dr. Bardhyl Demiraj në studimet gjuhësore dhe filologjike. Ky Festschrift, që i kushtohet Bardhyl Demiraj, profesor universiteti, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; historian i gjuhës dhe etimolog, historian i shkrimit dhe alfabetizimit të shqipes, përfaqësues i shquar i filologjisë së tekstit me kërkimet dhe botimet që ka realizuar ndër vite; organizator tubimesh shkencore ndërkombëtare të suksesshme; nyje ndërlidhëse e albanologjisë në Europë; është titulluar në shërbim të dijes sonë të shenjtë, nënkuptuar

më të shenjtën albanologjinë, së cilës, sikurse nënshkruan shpesh në letrat shoqërore, i qëndroi besnik gjatë gjithë veprimtarisë së tij studiuere.

Në vijim të veprimtarisë, mbi vëllimin referuan edhe studiueset: prof. asoc. dr. Evalda Paci, e cila mbajti kumtesën “Filologjia e teksteve të vjetra në vëllimin kushtuar prof. Bardhyl Demirajt”; prof. dr. Mimoza Kore mbajti kumtesën “Historia e gjuhës shqipe dhe e trevave shqiptare në librin dedikuar prof. Bardhyl Demirajt”, si dhe prof. dr. Mimoza Priku, e cila mbajti kumtesën “Gjuhësi variantesh dhe shqipja në kontakt në vëllimin festiv për nder të prof. Bardhyl Demirajt”.

Në përmbyllje të aktivitetit, prof. dr. Bardhyl Demiraj shprehu mirënjohjen e tij për vlerësimin dhe përkushtimin e kolegëve, duke theksuar se ky botim zë një vend të veçantë në punën dhe kujtesën e tij. Ai nënvizoi rëndësinë e lidhjeve të qëndrueshme me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, institucionet akademike dhe kolegët, si dhe rolin e përvojës së tij akademike në Shqipëri dhe jashtë saj në formësimin e rrugëtimit të tij shkencor.



Fjalë përshëndetëse nga Kryesia e Akademisë së Shkencave në promovimin e librit "Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti" në nderim të prof. dr. Bardhyl Demiraj



-Akad. Gëzim Hoxha: Ky botim vjen si një shenjë e merituar vlerësimi për një karrierë të gjatë dhe të shquar universitare e shkencore, të shtrirë përgjatë rreth 45 viteve. Prof. dr. Demiraj, anëtar i jashtëm i ASHSH-së, është një nga përfaqësuesit më të spikatur të studimeve albanologjike në hapësirën akademike evropiane.

Në veprimtarinë e organizuar nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, në bashkëpunim me Komisionin e përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë, akad. Gëzim Hoxha Kryetar i SSHSHA, mbajti fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë së ASHSH-së: "Të nderuar kolegë,

Të nderuar studiues dhe miq të albanologjisë,

Kryesia e Akademisë e Shkencave e Shqipërisë ka kënaqësinë të përshëndesë këtë veprimtari shkencore kushtuar prezantimit të vëllimit "Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti", një Festschrift në nderim të akademikut të jashtëm të Akademisë sonë, prof. dr. Bardhyl Demiraj.

Në traditën akademike ndërkombëtare, botime të tilla përfaqësojnë një nga format më të larta të vlerësimit që komuniteti shkencor i bën një studiuesi. Ato nuk janë vetëm një përmbledhje studimesh nga kolegët studiues dhe kërkues shkencorë të njohur në albanologji, por edhe një dëshmi e ndikimit të thellë, që një personalitet shkencor ka ushtruar në zhvillimin e kësaj fushe identitare të studimit.

Ky botim vjen si një shenjë e merituar vlerësimi për një karrierë të gjatë dhe të shquar universitare e shkencore, të shtrirë përgjatë rreth 45 viteve. Prof. dr. Demiraj është një nga përfaqësuesit më të spikatur të studimeve albanologjike në hapësirën akademike evropiane. Ai ka zhvilluar veprimtarinë e tij si gjuhëtar dhe filolog në Universitetin Ludwig Maximilian të Mynihut, ku ka drejtuar njësinë e shqipes në Departamentin e Gjuhësisë së Përgjithshme dhe të Indoeuropianistikës, një qendër e rëndësishme e studimeve albanologjike në Evropë.



Veprimtaria e tij kërkimore përfshin një gamë të gjerë fushash që nga etimologjia dhe gjuhësia krahasimtare indoeuropiane, historinë e gjuhës shqipe dhe të shkrimit të saj, vëllimit kushtuar shqipes në Fjalorin e madh të indoeuropianishtes dhe gjuhëve indogjermane të botuar nga Universiteti i Mynihut. Krahas kësaj, ai ka dhënë kontribute të rëndësishme në përgatitjen dhe botimin kritik të veprave të autorëve të vjetër të letërsisë shqipe dhe në studimin e dëshmimeve të rralla leksikore të shqipes në kontekste aloglotte dhe në dorëshkrime arkivore.

Bilanci i kësaj veprimtarie është mbresëlënës: 17 studime monografike dhe përmbledhje artikujsh shkencorë në gjuhësi, mbi 220 artikuj të botuar në revista të specializuara ndërkombëtare, dhjetëra përkthime editoriale dhe recensime kritike, si dhe organizimi i disa konferencave ndërkombëtare të rëndësishme kushtuar albanologjisë në kontekstin ballkanik, evropian dhe indoeuropian.

Për të shprehur mirënjohje dhe respekt për këtë kontribut të gjerë dhe të qëndrueshëm, në këtë vëllim përkujtimor janë bashkuar studiues me renome ndërkombëtare në fushën e indoeuropianistikës, gjuhësisë krahasimtare, ballkanologjisë dhe albanologjisë, nga Gjermania, Austria, Zvicra, Polonia, Rumania, Italia, Greqia dhe nga Shqipëria. Kontributet e tyre përbëjnë një panoramë të pasur të zhvillimeve të sotme në këto fusha dhe dëshmojnë respektin e gjerë që gëzon figura dhe vepra e prof. Demirajt në komunitetin shkencor ndërkombëtar.

Në programin e këtij aktiviteti do të kemi mundësinë të dëgjojmë edhe disa nga paraqitjet tematike që pasqyrojnë fushat kryesore të studimeve të përfshira në këtë vëllim. Studiuesja Anila Omari do të ndalet në prurjet e gjuhësisë indoeuropiane në këtë botim kushtues; akademik Shaban Sinani në mënyrë shumë të sintetizuar do të konfigurujë shumëanshmërisht figurën e prof. Demirajt në Albanologji; Evalda Paci do të trajtojë çështjet e filologjisë së teksteve të vjetra; Mimoza Kore do të paraqesë aspekte që lidhen me historinë e gjuhës shqipe dhe të trevave shqiptare; ndërsa Mimoza Priku do të ndalet në problematikën e gjuhësisë së varianteve dhe të shqipes në kontakt me gjuhë të tjera. Në këtë kuptim, ky libër-kushtim nuk është vetëm një nderim personal për prof. Bardhyl Demirajn, por edhe një pasqyrë e denjë e gjendjes dhe e zhvillimeve të sotme të studimeve albanologjike në kontekstin më të gjerë të kërkimit evropian.

Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë është një nder i veçantë që prof. Bardhyl Demiraj është pjesë e saj si akademik i jashtëm. Kontributi i tij përfaqëson një urë të rëndësishme lidhëse midis albanologjisë në Shqipëri dhe asaj ndërkombëtare.

Duke përgëzuar përgatitësit e këtij vëllimi – studiuesit Anila Omari, Shaban Sinani dhe Ledio Hala – si dhe të gjithë autorët pjesëmarrës, dëshirojmë të shprehim bindjen se ky Festschrift do të mbetet një dëshmi e qëndrueshme e respektit të komunitetit shkencor për veprën dhe personalitetin e prof. Bardhyl Demirajt.



“Ditari i tranzicionit ekonomik: Shqipëria më afër Bashkimit European”, libri XII, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Akademik Anastas Angjeli sjell për lexuesin librin më të ri të kolanës “Ditari i tranzicionit ekonomik: Shqipëria më afër Bashkimit European. Shpërblimi i reformave”, libri XII, një botim që analizon rrugëtimin ekonomik dhe institucional të Shqipërisë në procesin e integritit evropian.

Ky libër përbën një reflektim të thelluar mbi transformimet që ka përjetuar vendi gjatë tranzicionit, duke u ndalur veçanërisht në zhvillimet e viteve të fundit dhe në progresin e Shqipërisë drejt Bashkimit European. Përmes analizave dhe studimeve të shumta, autori ofron një panoramë të gjerë të reformave politike, ekonomike dhe institucionale që kanë shoqëruar këtë proces të gjatë dhe kompleks.

Në fokus të librit është integrimi europian, i cili paraqitet si projekti më i rëndësishëm strategjik i Shqipërisë në periudhën e pas-komunizmit. Autori analizon sfidat e tranzicionit, ndërtimin e institucioneve demokratike, reformat në drejtësi, konsolidimin e ekonomisë së tregut dhe përpjekjet për forcimin e shtetit të së drejtës.

Botimi trajton gjithashtu zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare dhe ndikimin e faktorëve globalë, si pandemia, krizat ekonomike dhe tensionet gjeopolitike, duke evidentuar mënyrën se si ekonomia shqiptare po përshtatet me një strukturë të re zhvillimi ku sektorë si turizmi, shërbimet dhe investimet marrin një rol gjithnjë e më të rëndësishëm.

Përmes një analize të argumentuar dhe të dokumentuar, akademiku Angjeli thekson se Shqipëria sot ndodhet në një moment të rëndësishëm të rrugëtimit të saj europian. Sipas tij, progresi i arritur është rezultat i reformave të ndërmarra dhe i angazhimit institucional, ndërsa vijimi i këtij procesi kërkon përkushtim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim të gjerë politik dhe shoqëror.

“Ditari i Tranzicionit Ekonomik”, Libri XII, vjen si një kontribut i rëndësishëm analitik për të kuptuar zhvillimet ekonomike dhe politike të Shqipërisë, duke ofruar një perspektivë të qartë mbi sfidat dhe mundësitë e vendit në rrugën drejt integritit të plotë në Bashkimin Europian.



Të tjera

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kryesia e saj i urojnë akademik
Besim Elezit: Gëzuar ditën e lindjes!**



Kirurgu i njohur akad. Besim Elezi lindi më 20 mars të vitit 1935, në Ftterrë të Sarandës, ndërsa shkollimin e kreu në Gjirokastrë. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, nga viti 1952-1957, ku u diplomua si mjek. Në vitin 2008 u shpall "Akademik i asociuar", dhe në 2010-n "Akademik". Ai është anëtar i ASHSH-së, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike.

Akad. Elezi është specializuar për anesteziologji në Danimarkë, për endokrinokirurgji në Rumani, për kirurgji të përgjithshme në Kinë, për kirurgji ezofagale në Francë, ndërsa ka bërë edhe specializime të tjera në Itali e në Austri.

Gjatë karrierës së tij ka shumë vepra shkencore eksperiencia shumëvjeçare pedagogjike, kërkimet shkencore dhe përvojat e pasura klinike. Bëhet fjalë për 76 publikime që përfshijnë libra, monografi, artikuj dhe referate, ku më rëndësishmet janë monografia “Ekinokokoza e mushkërive. Rezultatet e larta të mjekimit” dhe libri “Kirurgjia: principe dhe praktika” me 2 vëllime (v.2000), i bazuar në tekste të mirënjohura ndërkombëtare, i cili plotësoi një boshllëk në literaturën mjekësore shqiptare me përmbledhjen eksperiencave shumëvjeçare pedagogjike, kërkimeve shkencore dhe përvojave të pasura klinike, të ilustruara me një shumëllojshmëri fotografish nga fondi personal.

Akad. Elezi ka shkruar edhe vepra të tjera me vlerë në fushën e kirurgjisë si “Hidatidoza parësore dhe dytësore në Shqipëri” (1992), por edhe studimet në fushën e hidatologjisë, të cilat përbëjnë një kontribut të veçantë dhe janë mirëpritur në shumë konferenca e takime ndërkombëtare e më gjerë.

Për vite me radhë ai ka kontribuar në ngritjen e shërbimit të kirurgjisë në Shqipëri.

Akad. Besim Elezi mban disa tituj dhe grada “Doktor i shkencave mjekësore”, gradën “Docent” e “Profesor”, titujt “Akademik i asociuar” e “Akademik”. Akademiku e kirurgu i shquar, gjithë karrierën e tij e zhvilloi në dyert e spitalit në qendrën spitalore “Nënë Tereza”, ku ka dhënë një kontribut të madh në fushën e mjekësisë.

Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes akademikun Nazim Gruda



Akademia e Shkencave e Shqipërisë i përcjell urimet më të përzemërta për ditëlindjen studiuesit të shquar në fushën e hortikulturës dhe anëtarit të saj të nderuar akad. Nazim Gruda.

Akad. Nazim Gruda ka marrë titullin “Doktor i shkencave” nga Universiteti Teknik i Mynihut në Gjermani. Në Universitetin Humboldt të Berlinit u kualifikua me titullin shkencor Habilitation (kualifikimi më i lartë pasuniversitar në Gjermani) me të drejtën e mësimdhënies universitare, ndërsa në Universitetin e Bonit fitoi titullin Docent e Profesor. Ai është fitues i çmimit “Dr. Heinrich Bauer”, dhënë nga Universiteti Teknik i Mynihut (2003), si dhe është emëruar Courtesy Associate Professor në Universitetin e Floridës, SHBA (2004). Në vitin 2003 ka qenë shkencëtar në Teagasc–Kinsealy Research Centre në Irlandë, ndërsa në vitin 2007 studiues ftuar kërkimor i në Virginia Tech, Blacksburg, SHBA.

Që nga viti 2006 emri i tij përfshihet në botimin ndërkombëtar “Who is Who in the World”. Në konkursin e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2018) ka marrë Çmimin Kombëtar të Shkencave të Natyrës. Në vitin 2020 është nderuar nga Akademia e Shkencave e Kinës me titullin “Shkencëtar i shquar”, ndërsa në vitin 2024 u kualifikua si “Investigador Distinguido – Maria Zambrano” në Universitetin Politeknik të Kartagenës në Spanjë. Në vitin 2025 u nderua përsëri si “Shkencëtar i shquar” nga Akademia e Shkencave e Kinës.

Akad. Gruda është drejtues i studimeve të shumta studentore dhe ka mbajtur ligjërata në disa universitete gjermane. Ai është anëtar i këshillave shkencore të shumë simpoziumeve, konferencave dhe kongreseve ndërkombëtare, si dhe drejtues ose bashkëdrejtues i seksioneve shkencore në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare. Ndër

të tjera, ai ka qenë pjesë e organizimit ose drejtimit të sesioneve shkencore në konferenca ndërkombëtare në Quebec City (Kanada, 2009), Amman (Jordani, 2012), Brisbane (Australi, 2014), Zagreb (Kroaci, 2014), Chisinau (Moldavi, 2015), Evora (Portugali, 2015) dhe në disa aktivitete shkencore në Tiranë (2011, 2014). Pjesëmarrja në konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare si ligjërues i ftuar, kryetar sesionesh shkencore dhe anëtar i komiteteve shkencore në shumë kongrese ndërkombëtare të hortikulturës në Evropë, Afrikë, Azi, Amerikë dhe Australi ka një vijueshmëri të pandalshme. Veçanërisht intensive ka qenë ajo në vitet e fundit.

Në vitet 2023–2024 ai ka qenë Keynote speaker, bashkë-kryesues i sesioneve shkencore dhe anëtar i komiteteve organizuese në një sërë konferencash dhe simpoziumesh ndërkombëtare në Greqi, Lituani, Spanjë, Marok, Arabinë Saudite dhe Meksikë. Në vitin 2025 ai mbajti ligjërata të ftuara në Akademinë e Shkencave të Kinës, në Akademinë e Shkencave të Lituanisë, si dhe në disa konferenca ndërkombëtare mbi prodhimin hortikulturor dhe ndryshimet klimatike. Po atë vit ishte gjithashtu koordinator dhe moderator i workshop-it të FAO-s mbi menaxhimin e klimës dhe ujit në kuadër të simpoziumit ndërkombëtar GreenSys 2025 në Almeria, Spanjë.

Në vitin 2026 ai është ftuar si ligjërues në Universitetin e Çukurovës në Adana (Turqi), në Simpoziumin ndërkombëtar për perimet dhe patatet në Kretë (Greqi), si dhe në Simpoziumin e 14-të të Kongresit Botëror të Hortikulturës (IHC) në Kyoto, Japoni.

Aktualisht ai është zëvendës-president i Unionit të Akademive Evropiane për Shkencat e Aplikuara të Bujqësisë, Ushqimit dhe Natyrës (UEAA); një nga dy përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në grupin e punës të ALLEA; zëvendëskryetar i Seksionit të Perimeve, Bimëve Rrënjore dhe Zhardhokore dhe kryetar i Grupit të Punës për Evropën Juglindore në Shoqatën Ndërkombëtare të Shkencave të Hortikulturës (ISHS); si dhe kryetar i Grupit të Punës për prodhimin në serra për Evropën Juglindore. Që nga viti 2023 është gjithashtu ekspert për “Green Agriculture” për Evropën dhe Azinë Qendrore në Organizatën e Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara (FAO).

Prof. Gruda është Editor-in-Chief i një reviste shkencore ndërkombëtare të botuar nga Taylor & Francis, anëtar i bordeve redaktuese të disa revistave shkencore dhe ekspert vlerësues për projekte kërkimore në një numër institucionesh dhe organizatash ndërkombëtare. Ndër to përfshihen FAO, Komisioni Evropian (Horizon dhe COST), Fondacioni Kombëtar i Kërkimit pranë Zyrës së Kryeministrit të Singaporit, Zyra Federale Gjermane për Ushqimin dhe Bujqësinë, Ministria Italiane e Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit, Fondacioni Kombëtar i Kërkimeve i Afrikës së Jugut, Instituti Mesdhetar Agronomik i Chania – CIHEAM IAMC, si dhe universitete dhe institucione kërkimore në Arabinë Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Shqipëri.

Hulumtimet e tij janë përqendruar në risitë për prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit hortikulturor, me fokus në substratet bimore, hortikulturën urbane dhe perimet. Akad. Gruda është autor i mbi 400 publikimeve shkencore, prej të cilave mbi 200 të indeksuara në Scopus, dhe renditet ndër studiuesit me indeks të lartë citimesh. Ai është autor ose bashkautor i 38 librave dhe kapitujve librash, mbi 100 raporteve tekniko-shkencore, si dhe ka prezantuar mbi 100 referate dhe postera në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare në Evropë, Amerikë, Azi, Afrikë dhe Australi. Sipas vlerësimit të ekspertëve të Universitetit Stanford, ai renditet ndër 2 % shkencëtarët më me ndikim në

botë (“World’s Top 2 % Scientists”), ndërsa sipas Google Scholar, në fushën e hortikulturës ai renditet ndër 10 shkencëtarët më të suksesshëm në Evropë.

Prof. Gruda është anëtar nderi i Akademisë Rumune të Shkencave Bujqësore dhe Pyjore “Gheorghe Ionescu-Şişeşti”, anëtar korrespondent i Accademia dei Georgofili në Itali - akademia më e vjetër në botë për bujqësinë - anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Lituaniës, si dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes akademikun Adem Bunguri



Në këtë ditë të veçantë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë i përcjell urimet më të përzemërta për ditëlindjen studiuesit të shquar të arkeologjisë prehistorike, drejtuesit të kërkimeve dhe anëtarit të saj të nderuar, akad. Adem Bunguri.

Me një kontribut të spikatur në studimet arkeologjike, ai vlerësohet për maturinë shkencore dhe për formulimin e përgjithësimeve të rëndësishme mbi qytetërimet prehistorike të Shqipërisë dhe Kosovës. Gjatë karrierës së tij shkencore ka qenë pjesëmarrës, drejtues dhe bashkëdrejtues në më shumë se 60 ekspedita arkeologjike në terren, kryesisht në Shqipëri dhe Kosovë, por edhe në Maqedoninë e Veriut (Dibër-Pollog), duke dhënë një kontribut të çmuar në kërkimet dhe zbulimet arkeologjike në rajon.

Ai ka bashkëdrejtuar projekte të rëndësishme shkencore në bashkëpunim me shkolla arkeologjike europiane nga Gjermania, Italia, Polonia dhe Greqia, ndërsa veprimtaria e tij botuese përfshin mbi 70 artikuj shkencorë në revista të specializuara në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe 8 monografi shkencore si autor apo bashkëautor. Punimet e tij janë prezantuar në një sërë kongresesh ndërkombëtare të arkeologjisë prehistorike në shumë vende të Europës.

Ndër kontributet më të rëndësishme të tij spikasim formulimi i hipotezës mbi modelet e ndryshme të neolitizimit të territorit të Shqipërisë, studimet mbi rrugët dhe modulet e indoeuropianizimit të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe evidentimi i metalurgjisë prehistorike dhe përcaktimi i provincave të pavarura metalurgjike gjatë Eneolitit dhe Bronzit të Vonë në këto hapësira gjeo-kulturore. Interesat e tij shkencore janë përqendruar veçanërisht në studimin e kulturës së epokës së Bronzit dhe në proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor.

Një nga kontributet e tij më të rëndësishme është formulimi dhe argumentimi për herë të parë i hipotezës anatoliane për migracionet e Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, duke ofruar një qasje të re shkencore përballë hipotezës së migracionit “kurgan”, e cila kishte mbizotëruar për një kohë të gjatë në arkeologjinë prehistorike shqiptare.

Për veprimtarinë dhe kontributet e tij të shquara është nderuar me çmime dhe tituj të rëndësishëm, ndër të cilët çmimi i parë “Dea Dardanicae” (Kosovë, 2018), titulli “Mjeshtër i Madh” (2021) dhe “Qytetar Nderi i Peshkopisë” (2023).

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron akademikun Stefan Çapaliku në ditën e lindjes



Akademia e Shkencave i përcjell urimet më të përzemërta në ditën e tij të lindjes akademikut dhe studiuesit të letërsisë e të arteve, Stefan Çapaliku.

I lindur në Shkodër në vitin 1965, akad.Stefan Çapaliku është një nga zërat më të rëndësishëm të mendimit bashkëkohor shqiptar në fushën e letërsisë, dramaturgjisë dhe estetikës. Ai u diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës në vitin 1988 dhe më pas vijoi studimet e specializimit në Itali, në Republikën Çeke dhe në Angli. Në vitin 1996 mbrojti doktoraturën në Universitetin e Tiranës, duke shënuar fillimin e një veprimtarie të gjerë akademike dhe krijuese.

Gjatë viteve 1993–1998 ai drejtoi Departamentin e Letërsisë në Universitetin e Shkodrës, ndërsa në periudhën 1998–2005 shërbeu në Ministrinë e Kulturës si drejtor për politikën e librit dhe bibliotekave, duke kontribuar në zhvillimin e politikave kulturore në vend. Që nga viti 2005 është studiues në Akademinë e Studimeve Shqiptare dhe për shumë vite ka qenë profesor i estetikës në Universitetin e Arteve në Tiranë.

Krahas veprimtarisë akademike, akad. Çapaliku është një nga dramaturgët më të njohur shqiptarë të kohës sonë. Dramat e tij janë interpretuar në skena dhe festivale ndërkombëtare të teatrit, duke u vlerësuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai është shpallur dramaturgu më i mirë nga Ministria e Kulturës dhe institucione të tjera kulturore në disa vite, ndër të cilat 1995, 2003, 2007, 2012 dhe 2016. Përveç dramaturgjisë, ai ka kontribuar edhe si regjisor teatri dhe filmi.

Krijimtaria e tij përfshin poezi, prozë, drama dhe ese, ndërsa një pjesë e veprave të tij janë përkthyer në shumë gjuhë të botës, duke përfshirë anglishten, gjermanishten, frëngjishten, italishten, rumanishten, polonishten, bullgarishten, serbishten,

maqedonishten dhe turqishten. Në vitin 2021 ai prezantoi letërsinë bashkëkohore shqipe në veprën prestigjioze “Histoire de la littérature européenne”, botuar nga CNRS Editions në Paris.

Në vitin 2021 Stefan Çapaliku u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndërsa në vitin 2024 u emërua drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve, duke vijuar të japë një kontribut të rëndësishëm në studimin dhe promovimin e kulturës dhe arteve shqiptare.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron sot në ditën e lindjes akademiken Floresha Dado



Akademikja Floresha Dado, anëtare e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, personalitet i njohur në fushën e studimeve për letërsinë ka sot ditëlindjen.

Kryesia e Akademisë dhe kolegët e saj i urojnë:

Gëzuar ditëlindjen, jetë të gjatë dhe suksese në krijimtari!

Akad. Floresha Dado është një nga studiueset e mirëfillta shkencore të letërsisë shqipe dhe specialiste e teorisë së letërsisë në Departamentin e Letërsisë të Universitetit të Tiranës. Ajo prej vitit 2015 deri në janar të vitit 2021 ka qenë kryetare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Lindi në 24 mars 1947, në Vlorë. Pas mbarimit të studimeve akad. Dado ka dhënë kontribute të vazhdueshme në këshilla shkencore të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë dhe në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë. Si anëtare e senateve të Universitetit të Tiranës, ajo ka mbajtur kurse pasuniversitare të teorisë së letërsisë dhe të kritikës letrare, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë dhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, si dhe leksione pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës e ligjërata në Universitetin e Europës Juglindore dhe në Universitetin e Tetovës.

Është autore dhe bashkautore e veprave, monografive dhe teksteve universitare në fushën e letërsisë, si dhe autore e shumë referimeve në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit; hartuese e shumë artikujve (mbi 100), të botuar në organe shkencore dhe kulturore. Ka qenë anëtare e Komisionit të Lartë të Kualifikimit Shkencor pranë MASH (1989-2005).

Akad. Dado është njohëse e disa gjuhëve anglisht, italisht, frëngjisht, rusisht. Ajo ka punuar si studiuese e letërsisë shqiptare dhe specialiste e teorisë së letërsisë në Universitetin e Tiranës nga viti 1982 deri në vitin 2015.

Gjatë viteve 1969 - 1982 ka qenë bashkëpunëtore shkencore në sektorin e letërsisë shqiptare, pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave.

Ka qenë përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë (1989-1993), dekane e Fakultetit të Historisë e të Filologjisë (1992-1993), zëvendësrektore e Universitetit të Tiranës (2000-2003), themeluese dhe drejtore e shkollës pasuniversitare “Studime Europiane” (2001-2003). Në vitin 1982 ngarkohet me rikonceptimin dhe ndërtimin e lëndës së re “Teoria e letërsisë” pranë Katedrës së Letërsisë, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë.

Akad. Dado është hartuese e një fushe të re në studimet dhe nivelet tona universitare dhe pasuniversitare. Ajo ka botuar disa vepra të rëndësishme si: “Postmodernizimi – poetika e antirregullit”, “Poetika e romanit shqiptar”, “Letërsia shqiptare dhe proceset letrare”, “Moderniteti në letërsinë shqipe”, “Tipologji të romanit shqiptar”, “Teori dhe kritikë letrare”, si dhe studime e analiza të tjera.

Në 1981 fiton gradën shkencore “Kandidat i shkencave”, e konvertuar në vitin 1994 me gradën “Doktor”; në 1986 i jepet titulli pedagogjik “Docent”; në vitin 1995 fiton titullin “Profesor” dhe në vitin 2008 i jepet titulli “Akademike”.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron antropologun akademik Albert Doja në ditën e lindjes



Akademia e Shkencave e Shqipërisë i uron akademikut Albert Doja në ditën e lindjes: Jetë të gjatë dhe suksese në kërkimet shkencore!

Akad. Albert Doja është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, profesor i antropologjisë në Universitetin e Lilës në Francë.

Interesat e tij kërkimore përfshijnë problematika të ndryshme teorike dhe praktike që lidhen me historinë e mendimit dhe teoritë socio-antropologjike, epistemologjinë e shkencave sociale, poststrukturalizmin dhe neostrukturalizmin, antropologjinë e kulturës dhe të politikës së identitetit kulturor, fetar, gjinor, social dhe politik, manipulimet politike të kulturës, gjuhës, fesë dhe gjinisë, pushtetin e ideologjive, fesë dhe miteve në shoqëri dhe politikë, përkatësinë etnike dhe nacionalizmin, marrëdhëniet ndëretnike, migrimet ndërkombëtare dhe komunikimet ndërkulturore. Gjithashtu, kërkimet e tij janë zgjeruar me antropologjinë e simbolizmit dhe të komunikimit, marrëdhëniet e shkëmbimit dhe sistemet e komunikimit në shoqëri dhe politikë, trashëgiminë kulturore, tranzicionin demokratik dhe transformimet shoqërore, çështje të modernitetit dhe postmodernizmit, prejardhjen e dijes dhe transmetimit të njohurive, teknikat e trupit, konceptin e personit, ndërtimin e gjinisë, farefisninë dhe rolin e teknologjive riprodhuese, shëndetit reprodutiv dhe planifikimit familjar.

Kërkimet antropologjike i ka zhvilluar midis Shqipërisë dhe Europës Perëndimore e Europës Lindore.

Akad. Albert Doja është përpjekur të identifikojë format e ndryshme të dallimit midis praktikës së studimeve folklorike-etnografike dhe antropologjisë bashkëkohore, për të theksuar domosdoshmërinë e përqafimit të metodologjisë antropologjike në studimet e sotme shqiptare.

Jeta dhe karriera e antropologut akademik Albert Doja

Profesor universitar, titullar i sociologjisë dhe antropologjisë në Universitetin e Lille-s në Francë dhe anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në fushën e antropologjisë.

Ai ka marrë titullin e doktoratës në antropologji sociale në vitin 1993 nga Shkolla e Studimeve të Avancuara në Shkencat Sociale në Paris (EHESS) dhe akreditimin profesorial (Habilitation à Diriger des Recherches) në sociologji dhe antropologji në vitin 2004 nga Universiteti Paris Descartes (Sorbonne) në përmbushje me kërkesat kualifikuese si profesor universitetesh brenda sistemit akademik francez.

Më parë ai ka qenë Profesor Vizitues në Universitetin e Harvardit, anëtar nderi i i Departamentit të Antropologjisë në University College London dhe i komanduar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) si zëvendësrektor i Universitetit të Durrësit në Shqipëri. Ai ka mbajtur disa poste akademike në Shqipëri, Francë, Britani, Irlandë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe ka ligjëruar antropologji sociale si profesor i ftuar dhe ka zhvilluar kërkime në terren në shumë vende të tjera.

Ai është anëtar bordi në revista akademike ndërkombëtare dhe deri më tani ka publikuar disa libra dhe shumë artikuj origjinalë në revista ndërkombëtare të indeksuara me bord editorial. Ndër interesat e veçantë kërkimorë janë antropologjia e politikës dhe historisë; teoritë politike-antropologjike, analiza strukturore, poststrukturalizmi dhe neostrukturalizmi; politika e dijes, pushtetit dhe ideologjisë; antropologjia politike e simbolizmit dhe fesë; komunikimi ndërkulturor, marrëdhëniet ndëretnike dhe migrimet ndërkombëtare; etniciteti dhe nacionalizmi; trashëgimia kulturore dhe transformimet shoqërore e identitare; teknologjitë politike të vetvetes, personaliteti, formimi gjinor, organizimi farefisnor dhe aktivizmi riprodhues etj.

Botimet kryesore monografike janë: *Naître et Grandir chez les Albanais: La Construction Culturelle de la Personne* (2000); *Përdorimi politik i fesë në formimin e identiteteve: Rasti shqiptar* (2001); *Bektashism in Albania: Political history of a Religious Movement* (2008); *Invitation au terrain: Mémoire personnel de la construction du projet socio-anthropologique* (2013); "Shfaqja e Antropologjisë në Shqipëri" (Botim i Akademise, 2018).

**Kryesia e Akademisë së Shkencave i uron poetit akademik Xhevahir Spahiut:
Gëzuar ditëlindjen!**



I urojmë akademikut Xhevahir Spahiut në ditën e lindjes: Gëzuar Jetë të gjatë e plot shëndet!

Akad. Xhevahir Spahiut është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga viti 2008. Ai është një nga poetët më të mëdhenj të vendit.

Akad. Xhevahir Spahiut u afirmua si poet në fund të viteve 1960 me zërin e tij të spikatur poetik.

Kritika ka thënë fjalën e saj vlerësuese përmes artikujve studimorë rreth veprës së poetit Xhevahir Spahiut, si mjeshtër i fjalës dhe metaforave. Ai ka spikatur edhe në gjini të tjera letrare-artistike. Është autor i shumë teksteve poetike të këngëve të muzikës së lehtë, autor i disa skenarëve të filmave dokumentarë artistikë.

Poezia e Xhevahir Spahiut është përfaqësuar gjerësisht në të gjitha antologjitë e poezisë shqipe të botuara gjatë 20 viteve të fundit në Shqipëri dhe në gjuhë të huaja.

Gjatë jetës së tij akad. Xhevahir Spahiut ka punuar edhe si publicist e përkthyes i disa vëllimeve poetike të poetëve botërorë.

Jeta dhe krijimtaria e poetit akademik Xhevahir Spahiut

Xhevahir Spahiu lindi më 1 mars të vitit 1945 në Malind të Skraparit. Kreu studimet e larta në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë në UT (1967). Ka punuar gazetar në "Zërin e popullit" (1968-1977), redaktor në revistën "Nëntori" (1978- 1986), mësues (1986-1989), libretist në Teatrin e Operës dhe Baletit (1989-1993), sekretar I përgjithshëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë (1993-1998) dhe kryetar i saj (1998- 2001).

Gjatë jetës së tij ka botuar mbi 50 vepra poetike, monografi e studime estetike, mes të cilave shquhen vëllimet poetike; "Vdekje perëndive" (1977), "Zgjimi i thellësive" (1979), "Nesër jam aty" (1987), "Kohë e krisur" (1991), "Ferrparajsa" (1994), "Pezull" (1996), "Rreziku" (2001) etj.

Botime në gjuhë të huaj:

Libra dhe pjesë të zgjedhura të krijimtarisë poetike janë botuar në anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, holandisht, maqedonisht, turqisht, rrusisht, greqisht, rumanisht, arabisht, japonisht, kineze, kroatisht, hebraisht etj.

Ka fituar dhjetëra çmime kombëtare e ndërkombëtare në krijimtari letrare, publicistikë, tekste muzikore dhe skenarë filmash.

Është dekoruar me urdhra të lartë dhe medalje:

Udhri "Mjeshtër i madh" dhënë nga Presidenti i Republikës, Tiranë 2005;

Medalja "Naim Frashëri", 1972;

Medalja e Punës, 1974;

Urdhri "Naim Frashëri" ,kl.II, 1982.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron për festën e 7 Marsit- Ditën e Mësuesit



Akademia e Shkencave e Shqipërisë përcjell urimet më të përzemërta për të gjithë mësuesit, pedagogët dhe edukatorët shqiptarë në ditën e shënuar të 7 Marsit.

Kjo ditë është shpallur festë kombëtare në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e çmuar të mësuesve në formimin dhe edukimin e brezave të rinj, si dhe në ndërtimin e një shoqërie të mbështetur mbi dijen, kulturën dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Misioni i tyre fisnik mbetet themelor për përparimin e arsimit, të shkencës dhe të vetë shoqërisë shqiptare.

Më 7 mars 1887 u hap në Korçë Mësonjëtorja e parë kombëtare shqipe, një ngjarje me rëndësi të veçantë në historinë e arsimit dhe të ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Nën drejtimin e figurave të shquara të Rilindjes Kombëtare, si Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi, Thoma Avrami etj, kjo shkollë u bë vatër e përhapjes së dijes dhe e edukimit atdhetar.

Në këtë ditë simbolike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpreh vlerësimin më të lartë dhe mirënjohjen për të gjithë mësuesit, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm vazhdojnë të ndriçojnë rrugën e dijes dhe të edukimit.

Gëzuar 7 Marsin!

In memoriam

Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta fizikanin e talentuar akademik Artan Boriçin



Akademik Artan Boriçi, një prej mendjeve më të ndritura të shkencës shqiptare, u nda nga jeta në moshën 56-vjeçare, më 25 mars 2021, pas një beteje me Covid-19.

Në mesin e viteve 2000 u bë pjesë strukturore e Departamentit të Fizikës, ku drejtonte grupin e fizikës llogaritëse, entitet që energjizoi dukshëm në sasi dhe cilësi punimet që bazohen ose aplikojnë teknika të avancuara llogaritëse dhe simulime. Ai fitoi gradën doktor i shkencave matematike në një prej institucionet më të njohura universitare federale të Zvicrës. Bashkëpunoi me sukses me disa qendra të mirënjohura të fizikës dhe matematikës në Zvicër, Gjermani e më gjerë. U bë pjesë e ekipeve të specializuara për kërkime bërthamore europiane. Ishte një prej vlerësuesve dhe paravlerësuesve të konkursit të përvitshëm për çmimin Nobel në fizikë.

Akad. Artan Boriçi u ftua të bashkëpunonte dhe bashkëpunoi me agjencitë kërkimore të specializuara ngushtë nga Zvicra në Skoci. Akad. Artan Boriçi dha kontribute origjinale në shkencën europiane. Ai është propozues i një formulimi të ri, që sot citohet me emrin

Boriçi-Krojc. Studimet e tij janë pika reference brenda dhe jashtë vendit. Ai bashkëpunoi ngushtë me institucionet shkencore si Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe me institucione të tjera prestigjioze si Akademia Mbretërore e Shkencave të Suedisë (për propozimin e çmimeve Nobel në fizikë), Qendra e Kërkimeve Bërthamore Europiane CERN, Qendra e llogaritjeve intensive në Jylich të Gjermanisë etj. Ai ka mbrojtur gradën doktor i shkencave matematike në ETH, Zurich, Zvicër, në vitin 1996. Titullin profesor e ka marrë në Universitetin e Tiranës, në vitin 2010.

Akad. Boriçi punoi mbi 20 vjet si pedagog në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Ka shërbyer si zëvendësdekan i këtij fakulteti (2012) dhe si anëtar i këshillit shkencor. Që prej vitit 2012, ai drejtonte grupin e fizikës llogaritëse dhe të energjive të larta në departamentin e fizikës. Ka udhëhequr dy teza doktorale në fushën e fizikës së thërmijave elementare.

Akad. Artan Boriçi ka dhënë kontribute të rëndësishme në studimet e fizikës teorike. Ai është një prej pionierëve të rëndësishëm që ka shtyrë përpara metodologjitë e reja llogaritëse në LQCD dhe është i pari që u orientua drejt paraqitjeve ekzakte të fermioneve kirale në rrjet dhe simulimin e tyre. Në funksionet e tij si kërkues i mirënjohur dhe fizikan akad. Boriçi ka treguar qartë kompetencën më të lartë shkencore.

Ai punoi në drejtimet kërkimore të fizikës teorike dhe llogaritëse dhe në fushën e financës llogaritëse në Institutin Paul Scherrer të Zvicrës; në shkollën e lartë politeknike federale të Zyrihut e në Universitetin e Ediburgut (1996-2003). Ai ka 64 artikuj, të cituar 531 herë (ResearchGate), me 34 artikuj të indeksuar në SCOPUS, me indeks $H = 9$. Ka botuar në revistat e mirënjohura të fizikës, si Physical Review D dhe Journal of Computational Physics dhe ka qenë pjesëmarrës me referime në 49 konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, në 11 prej tyre si referues i ftuar.

Artan Boriçi u bë anëtar i Akademisë së Shkencave në vitin 2020.

Ai kontribuoi pa zhurmë, me modesti të rrallë, në themelimin e një shkolle të re kërkimore në vend dhe la pas një trashëgimi që do të vazhdojë të frymëzojë breza të tërë studiuesish.

Akad. Boriçi si studiues i shquar i mikrobotës së bërthamës e të grimcave elementare ka kontributin që ka dhënë në veprimtaritë shkencore të ASHSH-së e më gjerë. Puna kërkimore-shkencore e tij ishte avangardë jo vetëm për kohën, por ai ishte i pari që futi nocione, të cilat ende sot mbeten të reja për grupin e studiuesve. Ai ka lënë gjurmë që na kanë bërë krenarë për punën dhe veprën e lënë pas. Emri i akad. Artan Boriçit ka mbetur në Librin e Artë të Shkencës.

Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta Aleksandër Moisiun, aktorin shqiptar me famë botërore



Ikona e teatrit dhe dramaturgjisë botërore, Aleksandër Moisiu, u nda nga jeta më 22 mars 1935. Ai konsiderohej si aktori më i madh i teatrit të kohës së tij.

Aleksandër Moisiu lindi më 2 prill 1879 nga një baba shqiptar dhe një nënë me gjak arbëreshe. Fëmijërinë e kaloi në Trieste, në Durrës dhe në Grac, Austri. Shkollën e mesme e kreu në vitin 1898 në Grac. Pas vdekjes së të atit, rreth moshës 20-vjeçare, Aleksandri me të ëmën dhe dy motrat u vendos në Vjenë. Për një kohë të shkurtër ndoqi Konservatorin e Vjenës, por për arsye ekonomike u detyrua të punojë si duartrokitës në opera dhe si figurant në Burgteatër. Më pas, ai do të bëhej një prej aktorëve më të mëdhenj të skenës, që magjepsi publikun europian në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX. Veprimtarinë si aktor e filloi në vitin 1899, me nxitjen dhe mbështetjen e aktorit austriak Jozef Kainc (1858-1910).

Në vitin 1903 debutoi me sukses në Teatrin Gjerman të Pragës dhe një vit më pas në teatrin "Volksbühne" (Skena popullore) të Berlinit. Në Berlin gëzoi mbështetjen dhe ndihmën e regjisorit të njohur Maks Rajnhard (1873-1943), i cili e pranoi në teatrin e tij. Këtu u shqua në rolin e Osvaldit nga pjesa "Fantazmat" të dramaturgut norvegjez Henrik Ibsen (1828-1906), si dhe në rolet e personazheve të Bernard Shout (1856 -1950) dhe të Shekspirit (1564-1616).

Në vitin 1911, Moisiu shkoi me Ansamblin e Rajnhardit në një turne për interpretimin e rolit të Edipit në Shën Petërsburg, Rusi. I vlerësuar nga kritiku dhe dramaturgu Anatoli Lunaçarski (1875-1933), pas suksesit të korrur, u angazhua në shumë vende të Europës dhe në Amerikën Veriore. Ai luajti role të personazheve kryesore, duke filluar që nga tragjedia antike greke, deri te koha moderne, ku përfshiheshin dramaturgë gjermanë dhe austriakë. Megjithatë, Aleksandër Moisiu përmendet më së shumti për rolet e dramaturgjisë klasike si Hamleti, Edipi, Jedermani, Fausti apo dhe Fedja në pjesën

“Kufoma e gjallë” e prozatorit, dramaturgut dhe publicistit rus Leon Tolstoj (1828-1910) e më gjerë.

Në vitet para fillimit të Luftës së Parë Botërore, Aleksandër Moisiu konsiderohej si një prej aktorëve më të mëdhenj në hapësirën gjermanofolëse. Me një art të nivelit të lartë, ai mishëroi role kryesore në kryeveprat e teatrit klasik dhe në ato të kohëve të reja. Në historinë e artit skenik botëror, Moisiu u shqua sidomos për interpretimin e tij original, temperamentin e fuqishëm, thellimin filozofik, lirismin dhe bukurinë poetike të personazheve. Ka lënë mbresa edhe për zërin e tij që kishte një tingëllim të veçantë.

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton në ditën e tij të lindjes
veprimtarin e Rilindjes Kombëtare, poetin dhe dramaturgun Andon Zako
Çajupi**



Andon Zako Çajupi lindi më 27 mars të vitit 1866, ndërsa vdiq më 11 korrik të vitit 1930. Ai ishte poet, dramaturg dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare. U lind Sheper të Zagorisë, i biri i Harito Zakos, një tregtari duhani me tregje në zgjerim e sipër deri në Itali. Mori mësimet fillore në Nivan të Zagorisë, në shkollën greke të atjeshme.

Në vitin 1882 u vendos në Aleksandri, ku studioi frëngjisht për pesë vite tek Sainte Catherine des Lazaristes. Gjatë qëndrimit të tij në Aleksandri u takua me mjaft avokatë të huaj, që i dhanë bindjen të vazhdonte studimet për jurisprudencë. Më 1887-n, pasi bëri një vizitë në Sheper, që ishte e fundit për të, Çajupi shkoi në Zvicër, ku kreu studimet e larta dhe mori titullin e doktorit të drejtësisë. Në Kajro, ku u vendos përgjithnjë, punoi për një farë kohe si avokat. Nga fundi i shek. XIX mori pjesë gjallërisht në lëvizjen patriotike shqiptare dhe mbajti krahun e saj më të përparuar.


Në rrethet e gjera atdhetare u bë i njohur me një artikull që shkroi në kuadrin e diskutimit rreth çështjes së alfabetit në të cilin doli kundër adoptimit të alfabetit grek për gjuhën shqipe. Pothuajse në të njëjtën kohë me veprimtarinë atdhetare, Çajupi nisi edhe krijimtarinë letrare. Në vitin 1902 botoi librin "Baba Tomorri", që dallohet nga fryma luftarake, patriotike dhe popullore në brendi dhe në formë.

Në vitin 1909 bëri bujë me pamfletin "Klubi i Selanikut", ku satirizonte armiqtë e brendshëm të lëvizjes kombëtare shqiptare. Patriotizmi i flaktë dhe qëndrimi i prerë ndaj pushtuesve të huaj, e nxorën Çajupin në krye të patriotëve që vepronin në Egjipt.

Në historinë e letërsisë shqiptare Çajupi zuri vend jo vetëm si poet, por edhe si dramaturg. Rëndësi të veçantë kanë sidomos komeditë e tij "14 vjeç dhëndër" dhe "Pas vdekjes", me të cilat solli një ndihmesë me vlerë në zhvillimin e këtij zhanri në letërsinë tonë. Penës së Çajupi i përketin edhe tragjedia "Burri i dheut", "Pas vdekjes", "Fshati im" etj, si dhe dorëshkrime të pabotuara.

Komedia e tij "14 vjeç dhëndër" mbetet një krijimtari letrare e vyer falë filmit artistik "Përrallë nga e kaluara", realizuar me motivet e kësaj vepre nga mjeshtri i regjisë shqiptare Dhimitër Anagnosti.

Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta filozofin dhe akademikun Zija Xholi



Profesori i filozofisë në Universitetin e Tiranës, akademik Zija Xholi, u nda nga jeta më 21 mars 2012.

Ai lindi në Korçë, ku kreu Liceun Kombëtar Francez. Mori pjesë në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare si ilegal dhe më pas u përfshi në Brigadën XX S. Në vitin 1952 kreu studimet e larta për filozofi në Universitetin “Lomonosov” të Moskës dhe nisi punën si profesor i filozofisë në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës.

Prej vitit 1957 ai dha mësim në Universitetin e Tiranës në kurset e plota të filozofisë, të historisë së filozofisë botërore dhe të historisë së mendimit politik dhe filozofik shqiptar. Ai dha mësim në disa fakultete, duke përfshirë edhe degën e filozofisë që u hap në vitet '60.

Akad. Zija Xholi ka qenë dekan i Fakultetit të Shkencave Politike e Juridike (1974–1989). Në Universitetin e Prishtinës ka dhënë për disa vite leksione për mendimtarët e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Ai është bashkautor i teksteve universitare të filozofisë. Në veprimtarinë shkencore i është kushtuar studimit të mendimit filozofik shqiptar. Ka botuar monografinë “Jeta dhe veprat e Sami Frashërit” (1978), si dhe ka shkruar studime për jetën dhe veprën e rilindësve Naum Veqilharxhi, Zef Jubani, Jani Vreto, Pashko Vasa, N. Frashëri, Sami Frashëri, Petro Luarasi, por edhe për autorët e parë të letërsisë shqipe, të përmbledhura

në librat e tij “Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare” (1987) dhe “Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare, si Marin Barleti, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani (2003) etj.

Akad. Zija Xholi ka marrë Çmimin e Republikës të Shkallës së Parë.

Kujtojmë në ditën e lindjes Selim Islamin figurë e rëndësishme e arkeologjisë shqiptare, themelues i saj



Selim Islami, arkeolog, etnograf, historian dhe shkencëtar i shquar lindi më 18 mars 1923 në Pandalejmon të Sarandës. Shkollën e mesme e kreu në Elbasan në vitin 1943, ndërsa studimet e larta i përfundoi në Universitetin Lomonosov të Moskës në vitin 1951, ku mbrojti tezën mbi etnologjinë e disa kolonive shqiptare në Ukrainë (Kaukaz).

Jetoi për shumë kohë tek këta shqiptarë dhe disertacioni i tij u botua rusisht në një nga revistat autoritative ruse. Kur u kthye në Shqipëri nisi punën në Muzeun Etnografik dhe Arkeologjik të Tiranës, ku nisi të merrej me zanafillat e arkeologjisë. Prof. dr. Selim Islami, së bashku me prof. dr. Hasan Cekën, prof. dr. Skënder Anamalin dhe prof. dr. Frano Prendin ngritën themelet e arkeologjisë shqiptare, duke formësuar departamentet e saj, muzeun, bibliotekën, laboratorin dhe kabinetet e numizmatikës dhe antropologjisë. Prof.dr. Islami ka punuar si drejtor i Muzeut Arkeologjik të Tiranës. Ka qenë shef i sektorit të arkeologjisë mbi dhjetë vjet, zëvendësdekan i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë pranë Universitetit të Tiranës, ku ka zhvilluar lëndën e arkeologjisë klasike dhe historisë së lashtë të Shqipërisë në vitet 1956-1966.

Ai punoi rreth 40 vjet si punonjës shkencor në Institutin e Historisë dhe në vijim në Qendrën e Kërkimeve Arkeologjike, Institutin e Arkeologjisë, pranë Akademisë së Shkencave.

Në vitin 1962 dhe 1963 botoi dispensën universitare "Arkeologjia", në dy volume, shumë e nevojshme për studentët e asaj kohe. Për një kohë shumë të gjatë, prof. Islami ka qenë kryeredaktor i revistës "Iliria", ai u angazhua me Institutin e Monumenteve në gërmimin e qytetit antik në Zgërdhesh dhe në themelimin e revistës "Monumentet".

Islami dëshmoi për herë të parë procesin e etnogjenezës së ilirëve në vazhdimësinë kulturore dhe etnike nga ilirët të shqiptarët në periudhën e antikitetit të vonë dhe

Mesjetës së hershme. Interesi i tij u shtri edhe rreth tumave ilire në Kosovë. Në fillim të viteve '80, një grup arkeologësh ndërmorën gërmime arkeologjike në tumën e Llashticës, Kosovë, ku u gjet një inventar i pasur arkeologjik, i datuar në shek. VIII-VII para. Kr. Rezultatet e studimeve të tij, ai i ka prezantuar edhe në një seri simpoziumesh dhe kongresesh ndërkombëtare në Itali, Francë, Gjermani, Hollandë, Danimarkë, Kroaci, Slloveni, Greqi, Bullgari, Turqi etj. dhe ka mbajtur leksione mbi ilirët në universitete të mirënjohura europiane.

Trashëgimia kryesore e Selim Islamit janë padyshim veprat e tij shkencore, si "Kultura ilire e Tumave të Matit" dhe "Historia e Ilirëve", "Shteti ilir, vendi dhe roli i tij në botën mesdhetare", "Epiri antik: vështrim i shkurtër etnologjik, shënime për problemin etnik Iliria në mijëvjeçarin e i para erës së re" etj. Ai la pas edhe shumë dorëshkrime të pabotuara.

Falë kualifikimit të lartë shkencor dhe rezultateve të arritura në fushën e Arkeologjisë dhe Historisë, në vitin 1973 Selim Islamit i akordohet titulli i lartë shkencor "Profesor". Është dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë me Urdhrin "Naim Frashëri".

Prof. Selim Islami u shua më 26 tetor 2001, i shtruar për operacion në Romë të Italisë. Për kontributin e dhënë në arkeologji Selim Islamit ju dha pas vdekjes titulli "Nderi i Akademisë".

Kujtojmë në ditën e lindjes Faik Konicën, një nga personalitetet më në zë të kulturës dhe letërsisë shqiptare



Prozator dhe poet, publicist dhe estetist, kritik letrar dhe përkthyes, Faik Konica me veprën e tij të shumanshme pasuroi dhe ngriti në lartësi të reja fjalën shqipe dhe mendimin letrar shqiptar.

I lindur në Konicë, më 15 mars 1875 në një familje të vjetër feudale mësimet e para i mori në vendlindje, në gjuhën turke, arabe dhe greke. Më vonë hyri në liceun perandorak francez të Stambollit për të kryer pastaj shkollën e mesme në Francë. Ndoqi studimet për filozofi në Dizhon dhe Paris. Fitoi disa konkurse, duke u nderuar me çmime për aftësitë e tij intelektuale jo të zakonata. Më 1912-n u diplomua për letërsi në universitetin e Harvardit, SHBA.

Pasi boton broshurën "Shqipëria dhe turqit" (1895) në Paris ai vendoset në Bruksel (Belgjikë), ku nxjerr revistën "Albania". Kjo revistë politiko-kulturore dhe letrare u bë organi më i rëndësishëm e më me autoritet i Rilindjes sonë. E botuar në gjuhën shqipe, frënge dhe pjesërisht turke, si një enciklopedi e vërtetë, ajo propagandoi për vite me radhë (1897-1909) programin e lëvizjes kombëtare shqiptare, historinë dhe kulturën e popullit tonë.


Më 1909 Konica, si u mbyll revista "Albania" në Londër, i ftuar nga atdhetarët shkon në SHBA, ku drejton gazetën "Dielli" edhe më pas gazetën "Trumpeta e Krujës". Me themelimin e Federatës "Vatra", më 1912-n ai zgjidhet sekretar i përgjithshëm i saj. Faik Konica dhe Fan Noli, duke qenë udhëheqësit kryesorë të lëvizjes kombëtare shqiptare në

SHBA, shkuan në Londër për mbrojtjen e çështjes kombëtare në Konferencën e Ambasadorëve. Në kongresin shqiptar të Triestes (1913), që u mbledh për të kundërshtuar copëtimin e Shqipërisë nga armiqtë e saj, Konica u zgjodh kryetar. Gjatë Luftës së Parë Botërore dhe më pas, ai zhvilloi një veprimtari të dendur diplomatike në dobi të atdheut, në Austri, Zvicër, Itali e gjetkë.

Në 1921-shin u kthye në SHBA, ku u zgjodh kryetar i Federatës "Vatra", po ndërkaq në vitet '20 u lidh dhe ndikoi në lëvizjen demokratike që zhvillohej në Shqipëri. Këtë do ta bënte nëpërmjet gazetës "Dielli" dhe "Shqiptari i Amerikës".

U nda nga jeta në Uashington më 14 dhjetor 1942.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujton në ditën e tij të lindjes gjuhëtarin dhe shkrimtarin Aleksandër Xhuvani



Aleksandër Xhuvani lindi në Elbasan më 14 mars 1880 në një familje të njohur për kontributin kombëtar e kulturor. Mësimet e para i kreu në vendlindje, të mesmen në Çatillë të Maqedonisë së Veriut. Më pas studioi filologji në Athinë, ku edhe u diplomua. Është një nga pionierët e arsimit dhe të gjuhësisë shqiptare. Veprimtarinë e nisi si mësues në Kolegjin Arbëresh të Shën Dhimitër Koronës, për t'u kthyer më pas në Shqipëri, ku filloi të jepte mësim në Normalen e Elbasanit.

Ka qenë anëtar i Komisionit Letrar të Shkodrës, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, anëtar i Institutit për Studime Shqiptare, dekan i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Institutit të Studimeve, anëtar i redaksisë së Buletinit të Shkencave Shoqërore.

Që nga viti 1905, kur botoi artikullin e parë në revistën "Albania" të Faik Konicës e deri në fund të jetës, vijoi shkrimet publicistike, gjuhësore, pedagogjike dhe letrare.

Për një farë kohe drejtoi organin e Elbasanit "Kopshti letrar". Më pas botoi shumë studime mbi veprat e letërsisë së viteve '30. La një trashëgim të çmuar veprash gjuhësore, pedagogjike, teoriko-letrare. Veprat që ai la pas janë: "Libri i gjuhës shqipe" 1924; "Njohuritë e para të sintaksës shqipe" 1925; "Fillimet e pedagogjisë didaktike" 1926; "Pestaloci" 1927; "Fillime të stilistikës dhe të letërsisë së përgjithshme (me Kostaq Cipon) 1930; "Fillimet e psikologjisë 1933 etj.

Gjuhëtari shkrimtari dhe filologu Aleksandër Xhuvani u nda nga jeta më 2 nëntor 1961.

Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta Dhimitër Kamardën, gjuhëtarin dhe atdhetarin e madh arbëresh



Dhimitër Kamarda (Demetrio Camarda, 1821-1882) ishte klerik, gjuhëtar, filolog dhe historian i shquar italo-arbëresh, i konsideruar si një nga studiuesit më të rëndësishëm të gjuhës shqipe në shekullin XIX. U nda nga jeta papritmas më 13 prill 1879, në Livorno të Italisë, në momentin kur ishte duke skicuar një gramatikë të gjuhës shqipe. Ishte nga Hora e Arbëreshëve në Itali, afër Palermos.

Kamarda pasi mbaroi kolegjin në Romë, u vendos në Livorno në vitin 1851, ku mori pjesë në një rreth filologjik. Ai së bashku me Jeronim De Radën (Girolamo De Rada) ishin dy iniciatorët kryesorë të lëvizjes kulturore italo-shqiptare (arbëreshe) në Itali gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Vepra kryesore e Kamardës “Sprovë e Gramatikës Krahasuese të Gjuhës Shqipe” (1864) është puna e parë shkencore e studimit historik krahasues mbi temën, e cila vijoi me një shtojcë të dytë (1866), të cilën e hartoi për të treguar pasurinë e shqipes, nivelin e lëvrimin të saj dhe mundësitë shprehëse të folklorit e të letërsisë shqipe. Në fund të këtij vëllimi gjendet një listë prej rreth 4000 fjalësh. Ishte fjalësi më i gjerë si numër i shqipes, i botuar deri në atë kohë. Punimi i Kamardës ishte një vepër pioniere, jo vetëm lidhur me shqipen, por edhe për gjuhësinë italiane, duke i siguruar atij përgjithmonë një vend të nderuar mes albanologëve. Ai është interesuar edhe për përkthimet biblike në arbërishten e Italisë dhe për këtë ka qëndruar në Londër te princi Lui-Lysien Bonaparti, nipi i Napoleonit, i cili kërkonte të paraqiste përkthimin e pjesëve biblike në 200 gjuhë të botës me rastin e Ekspozitës Botërore. Në nëntor të vitit 1878 ai i është drejtuar A. Tomsonit në Stamboll që ta ndihmonte për shpërndarjen e librave të veta.

Kamarda ishte autor edhe i një gramatike tjetër të gjuhës shqipe, ndërsa botoi edhe librin për Elena Gjickën me titull “A Dora d’Istria gli Albanesi” (Dora d’Istrias, shqiptarët). Ai e vlerësonte shumë dhe kishte miqësi me Elenën. Ajo bëri që Kamarda të kishte lidhje me persona të rëndësishëm politikë dhe ekonomikë si: Luigi Napoleone – filolog e kimist, Max Ducker – historian prusian, Rudolf Krehl – president i shoqërisë lindore të Lipsia etj. Dhimitër Kamarda dha një kontribut të rëndësishëm me botimin e Alfabetit të përgjithshëm shqiptar në 1869-n. Ai, jo vetëm ka qenë ndër të parët që ka treguar në mënyrë sistematike dallimet e dy dialekteve kryesore të shqipes, por edhe që i ka përdorur për të shpjeguar faktet e ndryshme historike. Ka diskutuar me vëmendje problemin e standardizimit të shqipes, duke parë se si variantet e dialekteve vendore mund të shkriheshin në një gjuhë të shkruar për të arritur që të njiheshin përgjithësisht dhe të bëheshin një standard i pranueshëm. Disa prej propozimeve të tij për vendosjen e një alfabeti të përgjithshëm të shqipes kanë qenë mjaft të afërta me zgjidhjen përfundimtare të çështjes më 1908-n.

Ai njihet gjithashtu si një mbledhës i rëndësishëm i folklorit arbëresh.

Përkujtojmë sot në përvjetorin e ndarjes nga jeta Fan Stilian Nolin, një figurë themelore të historisë dhe kulturës shqiptare



Fan Noli është një nga figurat më të ndritura të kombit tonë. Ai u nda nga jeta më 13 mars 1965 në Ford Laurerdale, Florida të SHBA-së. Lindi më 6 janar 1882 në Ibrik Tepe në Edrene (Turqi), ku përfundoi dhe shkollën e mesme. Më 1904-ën shkoi në Egjipt, ku punoi si mësues e gjatë kësaj kohe u njoh me patriotë të shquar të kolonisë shqiptare të Egjiptit. Në këtë kohë përktheu në greqisht veprën e Sami Frashërit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”. Në vitin 1907, pas vajtjes së tij në Amerikë, krijoi shoqërinë “Besa-besë” në Boston.

Më 9 shkurt 1908, në moshën 26-vjeçare, Fan Noli u bë diakon (dhjak) në Bruklin, kurse më 8 mars 1908 Platoni, kryepeshkopi ortodoks rus i Nju Jorkut, e shuguroi si prift ortodoks. Vetëm dy javë më vonë, më 22 mars 1908, Noli i ri krenar mbajti për herë të parë liturgji në gjuhën shqipe, në 'Knights of Honor Hall' në Boston. Ky ishte hapi i parë drejt organizimit dhe njohjes zyrtare të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

Më 10 gusht 1911 ai u nis për në Europë, ku ndenji katër muaj dhe kreu shërbesa kishtarë në gjuhën shqipe për kolonitë në Kishinjov, Odesë, Bukuresht dhe Sofje. Përpjekjet e Nolit për një kishë kombëtare shqiptare u përmbushën në vitin 1937, kur Patriarkana e Stambollit njohu zyrtarisht Kishën Ortodokse Shqiptare Autoqefale.


Nga viti 1909 deri në vitin 1911 ai botoi gazetën “Dielli” dhe së bashku me Faik Konicën themeloi më 1912-n Federatën Panshqiptare Vatra të Amerikës. Në vitin 1912 përfundoi studimet e larta në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Harvardit dhe vite më vonë, më 1938-n mbaroi studimet e larta në Konservatorin e Muzikës së Bostonit. Në vitin 1920 Noli u zgjodh kryetar i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, ku nëpërmjet anëtarësimit të Shqipërisë në këtë lidhje, Shqipëria mori një njohje ndërkombëtare. Më 1921-shin ai botoi veprën e rëndësishme “Historia e Skënderbeut”.

Në qershor të vitit 1924, Fan Noli u bë figurë udhëheqëse në luftën për shndërrime demokratike në shoqërinë shqiptare. Me fitoren e Lëvizjes së Qershorit (1924), u vu në krye të qeverisë demokratike si kryeministër për një periudhë 6-mujore. Me dështimin e këtij procesi, Noli mërgoi në Evropë dhe më pas në SHBA (1932), ku u fokusua në krijimtari letrare, historike dhe muzikologjike.

Në vitin 1938, ai u diplomua në muzikë pranë Konservatorit të Muzikës në New England, ndërsa në vitin 1945 mori gradën Doktor i Filozofisë në Histori në Universitetin e Bostonit, me një disertacion kushtuar Gjergj Kastriot Skënderbeut. Përveç veprimtarisë shumë të rëndësishme politike, poetike e publicistike, gjatë këtij dhjetëvjeçari Noli përktheu tragjeditë e Shekspirit, rubairat e Omar Khajamit, romanin "Don Kishoti" të Servantesit etj.

Fan Noli është varrosur në Forrest Hill Cemetery, të Bostonit. Kisha Autoqefale që kishte krijuar atje, u bë më vonë Kryedioqeza ortodokse shqiptare në Amerikë e Kishës ortodokse në Amerikë.

Kujtojmë humanistin, studiuesin dhe përkthyesin Henrik Lacaj



Kujtojmë me respekt dhe mirënjohje figurën e shquar të kulturës shqiptare, Henrik Lacaj, i cili u nda nga jeta më 12 mars 1991. Ai mbetet një nga humanistët, studiuesit dhe përkthyesit më të përkushtuar që i dha kulturës sonë një pasuri të vyer intelektuale.

Henrik Lacaj lindi në Shkodër më 11 shkurt 1909. Mësimet fillore i nisi në kohën e okupacionit austriak në shkollën e Schul Bruderve. Mbas Luftës I Botërore vazhdoi studimet në Kolegjin Saverian të Jezuitëve, ku përveç shkollës fillore 5-vjeçare, kreu dhe gjimnazin klasik 8-vjeçar.

Në vitin 1930 fillon studimet e larta në fakultetin e letërsisë dhe të filozofisë në Universitetin e Padovës, në Itali, me orientim të filologjisë klasike dhe diplomohet në vitin 1935. Ai u kthye në atdhe dhe iu përkushtua me pasion arsimit, studimeve dhe përkthimit. Gjatë veprimtarisë së tij mbajti edhe detyra në fushën e arsimit, ndër të cilat redaktor i gazetës “Rinija Fashiste” në Shkodër (1939).

Në vitin 1935 emërohet nga Ministria e Arsimit profesor në gjimnazin e Shkodrës ku jep gjuhë shqipe, latinisht, greqishten e vjetër dhe italisht deri në vitin 1939. Gjatë kësaj kohe dha kontributin e vet në përgatitje pjesësh teatrale në rrethin e nxënësve. Bashkëpunoi me shoqëritë “Bogdani” e “Rozafa”. Mbas çlirimit, në vitin 1945, u emërua profesor në gjimnazin e Tiranës, ku dha shqip dhe latinisht. Në 1946 u emërua në Institutin Teknik të Tiranës, ku qëndroi dy vjet si profesor i shqipes. Nga vitet 1948- ‘49 transferohet në gjimnazin e Durrësit si profesor i gjuhës shqipe dhe i historisë.

Kontributi më i rëndësishëm i Henrik Lacajt lidhet me përkthimin në gjuhën shqipe të veprave madhore të letërsisë klasike botërore, veçanërisht nga latinishtja dhe greqishtja e vjetër. Përmes punës së tij të përkushtuar ai solli në shqip kryevepra të autorëve të mëdhenj të antikitetit dhe të letërsisë europiane, duke pasuruar ndjeshëm fondin e kulturës dhe të përkthimit shqiptar.

Ndër përkthimet e tij më të njohura janë “Bukoliket” e Virgjilit, “Zogjtë” e Aristofanit, “Mbreti Edip” i Sofokliut, “Metamorfozat” e Ovidit, si dhe “Rrethimi i Shkodrës” i Marin Barletit.

Përveç veprimtarisë së gjerë në përkthim, Lacaj është autor i studimeve dhe monografive për figura të rëndësishme të kulturës shqiptare si Pjetër Budi, Dom Ndoc Nikaj, Luigj Gurakuqi dhe Hilë Mosi. Ai është gjithashtu bashkautor i “Fjalorit latinisht - shqip”, një vepër me rëndësi për studimet filologjike dhe për mësimin e gjuhës latine në Shqipëri. Në krijimtarinë e tij përfshihen edhe drama, ese, artikuj studimorë dhe shkrime të botuara në revista të ndryshme shkencore e kulturore.

Akademia e Shkencave kujton me nderim në ditën e tij të lindjes gjuhëtarin e shquar akademik Mahir Domin



Gjuhëtari dhe albanologu i shquar, profesor dhe akademik Mahir Domi lindi në Elbasan më 12 mars 1915. Studimet e mesme i nisi në Normalen e Elbasanit dhe i vazhdoi e përfundoi në Liceun Kombëtar (francez) të Korçës (1937). Ai ndoqi studimet e larta për filologji klasike dhe u diplomua në Universitetin e Grenoblës (Francë) më 1941. Po atë vit filloi punën si mësues e më pas si drejtor në Shkollën Normale të Elbasanit. Që nga viti 1947 ai ish punonjës në Institutin e Shkencave, njëkohësisht pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik.

Akad. Domi ka marrë pjesë në hartimin e "Fjalorit të gjuhës shqipe" (1954). Me themelimin e Universitetit të Tiranës u caktua përgjegjës i katedrës së gjuhës shqipe (1957-1962) dhe i sektorit të gramatikës e dialektologjisë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë (1957-1991). Ka dhënë lëndët sintaksa e gjuhës shqipe, morfologjia historike e shqipes dhe historia e albanologjisë. Është një ndër anëtarët themelues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i Presidiumit të saj. Veprimtaria shkencore e akad. Mahir Domit shtrihet në shumë fusha të shkencave filologjike: në gramatikë (sintaksë e morfologji), histori e gjuhës, histori e albanologjisë, dialektologji e onomastikë, gjuhësi normative dhe kulturë e gjuhës, kritikë shkencore, histori e letërsisë etj.

Ai ka drejtuar punën për ngritjen e kartotekës së gramatikës dhe për hartimin e veprës "Gramatika e gjuhës shqipe" (në dy vëllime); është kryeredaktor i saj, redaktor e bashkautor i vëllimit II "Sintaksa". Ka hartuar tekstet universitare "Morfologjia historike e shqipes" (1961) dhe "Sintaksa e gjuhës shqipe", pjesa I (1968), pjesa II (1969). Në fushën e historisë së gjuhës ka shkruar disa artikuj e referate për problemin e origjinës së gjuhës shqipe dhe për çështje të marrëdhënieve të gjuhës shqipe me gjuhë të Ballkanit, sidomos me rumanishten, si: "Prapashtesa ilire dhe shqipe, përkime dhe paralelizma" (1974), "Konsiderata mbi tiparet e përbashkëta të shqipes me gjuhët ballkanike dhe mbi studimin

e tyre" (1975), "Mbi disa përkime dhe paralelizma sintaksore shqipe-rumune" (1977), "Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe, arritje dhe detyra" (1982).

Ka qenë anëtar i komisioneve për hartimin e projekteve të drejtshkrimit (1956, 1967) dhe të veprave "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe" (1973), "Fjalori drejtshkrimor" (1976), "Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe" (1981, 2002). Anëtar i komisionit organizues dhe delegat i Kongresit të Drejtshkrimit (1972, shih). Ka marrë pjesë në komisionet hartuese të një vargu fjalorësh terminologjikë, ndër të cilët edhe "Fjalori i termave të gjuhësisë" (1975).

Akad. Mahir Domi është autor i pjesës për letërsinë e vjetër shqiptare dhe letërsinë me alfabet arab në veprën "Historia e letërsisë shqipe", vëllimi I (1959), botim i Univeritetit të Tiranës, si dhe një ndër redaktorët e veprës "Historia e letërsisë shqiptare" (1983), botim i ASHSH. Si autor i një vargu recensioneve ka sjellë ndihmesë në zhvillimin e kritikës shkencore, duke i hapur rrugën hartimit të një historie të mendimit gjuhësor shqiptar. Me tekstet e sintaksës dhe të letërsisë së huaj akad. Mahir Domi ka dhënë ndihmesë edhe për arsimin e përgjithshëm. Ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë dy herë.

Ndër përkthimet e tij më të njohura janë "Bukoliket" e Virgjilit, "Zogjtë" e Aristofanit, "Mbreti Edip" i Sofokliut, "Metamorfozat" e Ovidit, si dhe "Rrethimi i Shkodrës" i Marin Barletit.

Akademia e Shkencave përkujton në ditën e tij të lindjes poetin arbëresh Zef Serembe



Zef Serembe, një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë arbëreshe dhe të romantizmit shqiptar, lindi më 6 mars 1844 në fshatin arbëresh San Kozmo Albaneze të Kalabrisë (i njohur nga vendësit edhe si Strigari), një qendër ku gjuha dhe traditat shqiptare janë ruajtur ndër shekuj.

Formimi i personalitetit krijues të Serembes lidhet ngushtë me klimën e trazuar politike të Italisë së shekullit XIX, në vitet e lëvizjeve kombëtare italiane (1848–1860). Në këtë periudhë edhe i ati i tij mori pjesë aktive në përpjekjet revolucionare, duke u dënuar me vdekje në mungesë nga qeveria burbone dhe ai u detyrua të jetonte në arrati. Kjo atmosferë e tensionuar historike ndikoi ndjeshëm në formimin e botëkuptimit dhe të ndjeshmërisë poetike të Serembes.

Krijimtaria e tij shquhet për një lirikë të pasur dhe të shumëllojshme tematike. Ai kultivoi poezinë atdhetare, filozofike, shoqërore dhe të dashurisë. Në vargjet atdhetare u bëri thirrje shqiptarëve për rezistencë dhe luftë kundër pushtimit osman, si në poezitë “Vrull” dhe “Dora d’Istrias”. Në lirikën filozofike dhe shoqërore Serembe pasqyroi konfliktin mes individit dhe shoqërisë së kohës, duke krijuar figurën e një heroi të ri, kryengritësit të vetmuar dhe shpesh të zhgënjyer nga jeta, siç shfaqet në poezitë “Elegji” dhe “Kujtim”. Poezia e Serembes është e përshkuar nga një ndjenjë e thellë malli dhe nga kontraste emocionale ku ndërthuren optimizmi dhe stoicizmi me tone mistike e pesimiste. Ajo pasqyron në mënyrë të ndjeshme dramën shpirtërore dhe zhgënjimin tragjik që përjetonin intelektualët arbëreshë të kohës.

Stili poetik i Serembes karakterizohet nga një ton patetik dhe oratorik në poezinë atdhetare dhe në një pjesë të lirikës shoqërore, ndërsa motivet e vetmisë, zhgënjimit dhe konfliktit me shoqërinë shprehen përmes një stili liriko-introspektiv. Ky stil përputhet me individualitetin e tij krijues, të dalluar për spontanitet dhe një sinqeritet pothuajse naiv, që i jep vargut freski dhe komunikim të drejtpërdrejtë emocional. Poezia e tij është e pasur

me kontraste figurative, me antiteza, metafora dhe simbole, ndërsa ruan edhe ndikimin e traditës së poezisë popullore.

Një pjesë e madhe e krijimeve të Serembes si poezi, drama dhe përkthime, ndër të cilat edhe një përkthim i Psalmeve të Davidit humbën gjatë jetës së tij endacake, pasi autori shpesh i rishikonte dhe i ndryshonte dorëshkrimet. Gjatë jetës ai botoi vetëm disa vepra: "Poesie italiane e canti originali tradotti dall'albanese" (Kozencë, 1883), në italisht dhe shqip; "Sonetti vari" (Napoli, 1891), një përmbledhje me 42 sonete dhe "Il reduce soldato, ballata lirica" (Nju-Jork, 1895), me vargje në italisht.

Krijimtaria e Zef Serembes mbetet një dëshmi e rëndësishme e jetës shpirtërore dhe e aspiratave të botës arbëreshe, si dhe një kontribut i çmuar në historinë e letërsisë shqiptare.

Kujtojmë në ditën e lindjes patriotin e shquar Kostandin Çekrezi, figurë e rëndësishme e historisë dhe publicistikës shqiptare



Kostandin Anastas "Kosta" Çekrezi lindi më 31 mars 1892 në Ziçisht, në Korçë. Pasi mbaroi shkollën 5-vjeçare në fshatin e tij të lindjes, ai vijoi studimet në shkollën e mesme greke në qytetin e Korçës më 12 qershor 1910. Dokumentet e shkollës tregojnë se ai u vlerësua si "nxënës i shkëlqyeshëm në të gjitha lëndët" dhe fitoi një bursë nga qeveria osmane për të ndjekur shkollën juridike në Selanik, të cilën e ndërpreu më 1912-n, për shkak të fillimit të Luftës I Botërore.

Pasi Shqipëria u shpall e pavarur, më 1912-n deri në vitin 1914 Çekrezi punoi në Vlorë si sekretar Gjykate, pastaj si përkthyes i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit pranë qeverisë së Ismail Qemalit dhe në administratën e Princ Vidit.

Çekrezi emigroi në SHBA kur ishte 23 vjeç. Ai u bë redaktor i gazetës "Dielli" në Boston dhe kryeredaktor i saj nga vitet 1915 - 1919. Gjatë kësaj kohe studioi për histori, ekonomi, administratë publike dhe gjuhë angleze në Universitetin e Harvardit, Boston. Dha leksione për histori në Universitetin Kolumbia, Nju Jork. Sipas Robert Elsie në vitin 1920 Çekrezi erdhi në Shqipëri për të marrë pjesë në Kongresin e Lushnjes.

Në vitet 1920-1922 u caktua përfaqësues i Shqipërisë në Uashington. U kthye sërish në Shqipëri, ku punoi si këshilltar në qeveri, ndërsa mori pjesë aktive dhe si organizator në kryengritjen anti-zogiste të Fierit, 1935, e cila u shtyp dhe Kosta u dënua me vdekje në mungesë. Ai shkoi në Francë, "ku u mbajt për ca kohë në kampin e përqendrimit "Vernet de l' Aiege". Këtu, u njoh me vullnetarët shqiptarë të Luftës së Spanjës, Skënder Luarasin, Mehmet Shehun, Hulusi Spahiun, me të cilët nuk pati marrëdhënie të mira, për shkak të ideologjizmit ekstrem marksist të tyre."

Në gjysmën e dytë të viteve 1940, Çekrezi si shumë atdhetarë të tjerë shqiptarë jashtë, të djathë a të majtë, u dënua me mërgim të përjetshëm. Ai u la në hije dhe nuk u përfill nga qeveria e Shqipërisë së pas luftës.

Pjesa më e madhe e veprave të tij janë botuar në SHBA (Boston, New York), ku ai jetoi dhe veproi gjatë emigracionit si: "Albania Past and Present" (1919) – një nga librat e parë për Shqipërinë i shkruar nga një shqiptar në anglisht; "Albania and the Balkans (1917)"; "Histori e Shqipërisë" (1921); "Histori e vjetër që nga kohërat e pellazgëve deri në rënien e Perandorisë Romake" (1921) "Histori e re e Europës" (1921); "Historia mesjetare e Europës" (478-1453) (1921). Ai shkroi veprën politike "The Third Plan for Partitioning Albania" (1951). Çekrezi ka shkruar edhe libra shkollorë si; "Letra, shkresa, fjalëtorë" (1917). Ai është autor i njërit prej fjalorëve të parë të hershëm anglisht-shqip "English-Albanian Dictionary" (1923).

Kostandin Anastas "Kosta" Çekrezi u nda nga jeta në Arlington, Virginia, pranë Washingtonit, më 10 janar 1959, në moshën 67-vjeçare.